

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

Sektori i Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP

MATERIAL MËSIMOR

Në mbështetje të mësuesve të drejtimit:

“SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE”

Niveli II i KSHK

NR. 3

Ky material mësimor i referohet:

➤ Lëndës profesionale: “Barnat mjekësore dhe alternative”, kl.11 (L-21-091-18)

➤ Temave mësimore:

- Njohuri mbi barnat.
- Format farmaceutike të barnave.
- Dozimi i barnave.
- Kujdesi në përdorimin e barnave.
- Rrugët e marrjes së barnave.
- Shpërndarja dhe metabolizimi i barnave në organizëm.
- Eliminimi i barnave.
- Faktorët që ndikojnë në efektin e barit.
- Barnat me efekt në qarkullimin e gjakut dhe zemër.
- Barnat me efekt në traktin e frymëmarrjes.
- Barnat me efekt në sistemin nervor.
- Barnat me efekt në sistemin e tretjes.
- Barnat me efekt tek syri dhe veshi.
- Kimioterapia.
- Alergjia medikamentoze dhe efektet e padëshiruara të barnave.
- Bimët mjekësore dhe barnat popullore.

Përgatiti: Elidona Elezaj

Tiranë, 2020

Tema 1. Njohuri të përgjithshme mbi barnat

Sipas përcaktimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë me fjalën bar do të kuptojmë të gjitha lëndët që zotërojnë veti kuruese, parandaluese dhe diagnostikuese.

Farmakologjia është shkencë që merret me studimin e barnave, është shkencë që studion :

1. Farmakokinetiken (thithjen, shpërndarjen, biotransformimin dhe eliminimin e barnave nga organizmi)
2. Farmakodinamiken (mekanizmin e veprimit të barnave dhe efektet që rrjedhin nga ky bashkëveprim)
3. Efektet e padëshiruara të barnave
4. Bashkëveprimet me barnat e tjera

Në varësi të origjinës së tyre barnat mund të jenë :

- Natyrale ;
- Sintetike ;
- Gjysëm sintetike.

Deri në mesjetë barnat kishin origjinë natyrore dhe mënyra e përgatitjes së tyre edhe sot me përmirësime të vogla i ngjan asaj të kohës së Galenit. Zhvillimi i barnave moderne fillon pas vitit 1800 dhe merr hov pas luftës së II botërore. Në vitin 1803 u bë izolimi i morfinës, në vitin 1846 dhe 1847 u raportua për efektin anestetik të kloroformit. Në vitin 1883 u përdor paracetamoli, në 1899 u zbulua aspirina, në 1941 u fut në përdorim penicilina e kështu me rradhë zbulimet e njëpasnjëshme kanë pasuruar shumë arsenalin e medikamenteve që disponohen sot në luftë kundër sëmundjeve të ndryshme.

Emërtimi i barit

Për çdo bar ekziston emërtimi shkencor që bazohet në emërtimin kimik të substancës vepruese. Ky emërtim është i vështirë dhe nuk përdoret në praktiken e përditshme. O.B.SH ka propozuar të përdoret emërtimi i përgjithshëm ndërkombëtar. Ky emërtim respekton në një farë mase prapashitesa dhe/ose parashitesa të caktuara që orientojnë mjekun për grupin farmakologjik të barit. Ky është emërtimi më i pershtatshëm që duhet të përdoret në praktiken e përditshme klinike. Emërtimi tregtar mund të jetë një emër që me disa germa shpreh emrin e firmës prodhuese dhe me gërmat e tjera të orienton për klasën terapeutike. Ky emërtim nuk keshillohet të përdoret vetëm në rastet e vecanta.

Fazat e studimit të barnave të reja

Studimi dhe zbulimi i një bari të ri ose patente kalon në këto faza:

- A) Studimi paraklinik. Ky studim realizohet në kafshë të ndryshme eksperimentale ku përfshihen edhe studimet invitro. Kur studimet eksperimentale paraklinike japin të dhëna premtuese kalohet në studimet klinike.
- B) Studimet klinike. Ky studim kryhet në njëri dhe protokollin e tyre detyrimisht duhet të miratohet paraprakisht nga Komisioni Shtetëror i Etikës Mjekësore. Nëse bari i ri kalon me sukses fazat e studimeve klinike ai lejohet të qarkullojë si si patente duke marrë lejen

e qarkullimit qe zakonisht jepet per nje periudhe 5 vjecare. Periudha e patentes zgjat zakonisht 5-15 vjet ne varesi te kerkeses qe ben firma prodhuese. Nese patentat shitet prodhimi realizohet teknikisht identik dhe ky prodhim mund te hidhet ne qarkullim me te njejtin emer si te patentes ose me emer tjeter. Pas mbarimit te periudhes kohore te mbrojtjes ligjore te patentes, bari konsiderohet xhenerik dhe industrite e ndryshme farmaceutike nuk pengohen ta prodhojne dhe tregtojne ate.

Koncepti i “ Barnave thelbësore “

Me barna thelbësore kuptojmë listen e produkteve të nevojshme të zgjedhura për të mjekuar shumicën e sëmundjeve që prekin njerëzit e atij vendi. Ideja e barnave thelbësore u fut në qarkullim në vitin 1975 me propozim të OBSH-së. Ekspertët e kësaj organizate kanë hartuar një listë tip e cila rishikohet vazhdimisht. Kjo listë model e OBSH-së shërben për specialistët e vëndeve të ndryshme për të hartuar listën e barnave thelbësore të vëndeve të tyre. Ideja e barnave thelbësore është pranuar në shumë vende të botës dhe ka dhënë rezultate pozitive vecanërisht aty ku standarti ekonomik është i dobët. Para disa vitesh edhe në vendin tonë është përpunuar lista e barnave thelbësore.

Tema 2. Format farmaceutike te barnave

Barnat sipas gjendjes se tyre fizike ndahen ne barna te forta, te lengeta dhe te buta.

A) Ne barnat e forta futen:

- Pluhurat mund te jene te thjeshta ose te perbera dhe perdoren direkt mbi lekure/mukoza ose merren me ane te gojes.
- Tabletat jane pluhura te komprimuara ne makineri te posacme. Ato vijne te gatshme ne farmaci, sherbehen shpejt, perdoren me komoditet, transportohen me lehtesi nga te semuret, kane kosto te lire prodhimi prandaj jane forma medikamentoze shume te perdorshme.
- Drazhete jane tableta me lende te posacme (shtrese sheqerore, cokollate, gome arabike, metilceluloze etj). Mbeshtjellja ka per funksion te korrigoje shijen, eren apo te mbroje barin nga veprimi I agjenteve te ndyshem atmosferike apo nga veprimi I lengut gastrik.
- Kapsulat jane mbeshtjellje te vecanta ku futet bari per te maskuar shijen apo eren e keqe apo per te mbrojtur barin nga veprimi I lengjeve te stomakut.
- Speciet (cajrat) shiten pa recete. Ato mund te jene te thjeshta ose perzierje drogash.

B) Ne barnat e lengeta futen:

- Tretesirat pergatiten nga tretja e plote e substancave te ngurta ne nje ose disa tretesa, ose nga perzierja e substancave te lengeta.
- Miksturat jane forma te ngjashme me tretesirat. Ato permbajne dy ose me shume substanca te tretshme.
- Ekstraktet ujore jane ekstrakte me ane te ujit te principeve active te bimeve nga pjeset e ndryshme te ketyre bimeve.

- Tinkturat janë ekstrakte alkolike, akoliko-ujore, alkoliko-eterike të principeve aktive të bimëve nga pjesët e ndryshme të këtyre bimëve.
 - Shurupet janë forma farmaceutike të lengeta që si tretësia kanë ujë me sheqer ose lengje frutash.
 - Aerozolet janë tretësira ujore që përdoren me anë të aparateve të posaçme.
 - Klizmat janë forma të lengeta që futen në rektum me anë të një aparati të thjeshtë që quhet irrigator. Klizmat mund të jenë mjekuese, ushqyese dhe pastruese.
 - Tretësirat e injektueshme duhet të jenë patjetër të sterilizuara. Format medikamentoze, që garantojnë sterilitet janë ampulat dhe flakonët.
- C) Në barnat e buta futen:
- Pomadat dhe pastat përdoren për lyerjen e lëkurës ose mukozave. Pomadat janë me të buta se pastat. Kur përqendrimi i lëndës së ngurte është nën 23% quhet pomadë. Nëse përqendrimi është mbi 23% quhet pastë.
 - Supostet përdoren në rrugë rektale.
 - Ovulet janë barna të buta që përdoren në vaginë. Kanë formë ovale.

Tema 3. Dozimi i medikamenteve

Për dozimin e medikamenteve përdorim njësitet e sistemit metrik e njësitet biologjike si më poshtë:

Sistemi metrik

Njësia baze e peshës në sistemin metrik është grammi.

1 kilogram (kg) = 1000 gram (g)

1 miligram (mg) = 0,001 gram (g)

1 mikrogram (mcg) = 0,001 miligram = 0,000001 gram

1 nanogram (n) = 0,000000001 gram

Njësia baze e vëllimit është litri.

1 dekaliter (dl) = 10 litra (L)

1 liter (L) = 1000 mililiter (ml)

Njësia baze e gjatësisë është metri

1 meter (m) = 100 centimeter (cm)

1 centimeter (cm) = 0,01 meter (m)

Në kushte shtëpie lengjet përdoren edhe në këto masa:

1 gotë uje = 240 ml

1 filxhan çaji = 120 ml

1 luge gjelle = 3 luge kafe = 15-20 ml

1 luge kafe = 5 ml

1 pike = 0,05 ml

Menyrat e dozimit te medikamenteve

1. Per te llogaritur numrin e tabletave qe do te marre i semuri perdoret formula

$X = D : H$ ku D= doza qe rekomandon mjeku dhe H= doxa qe ka nje kokerr

2. Per te llogaritur sasine e tretesires qe do te marre pacienti nga goja perdoret formula:

$X = D : H \times Q$ ku D= doza qe rekomandon mjeku dhe H= doxa qe ka nje preparati
Q = sasia ne ml, ne te cilen eshte tretur sasia e preparatit H

3. Per te llogaritur sasine e tretesires qe do ti injektohet pacientit perdoret formula :

$X = D : H \times Q$ ku X = sasia e ml qe do te marre I semuri
D = daza qe rekomandon mjeku
H = doza qe gjendet ne nje ampule
Q = ml qe ka nje ampule

4. Mënyra e llogaritjes së shpejtësisë së dhënies së tretësirave në rrugën intravenoze :

Kur mjeku rekomandon që një medikament të jepet në venë, në formë perfuzioni ai duhet të tregojë sasinë e lëngjeve që do të marr marrë dhe periudhën sa do të zgjasë injeksioni. Kështu psh mjeku mund të urdhërojë që një litër tretësirë të injektohet për tetë orë. Për të llogaritur shpejtësinë e injektimit është e nevojshme që, për atë tretësirë, të dimë nr e pikave që përmbahet në një mililitër (faktori pikë). Faktori pikë për tretr tretësirat ujore është 20.

Llogaritja bëhet në këtë mënyrë :

Veprimi 1 – sasia totale e tretësirës / nr e orëve = nr ml për orë.

Veprimi 2 – nr ml për orë / 60 = nr ml për min.

Veprimi 3 – nr ml për min x faktori pikë = nr pikave për min.

5. Formulatat standarte per llogaritjen e dozave ne pediatri jane :

- Formula Fried

Femije 0-1 vjec = mosha e femijes ne muaj x dozen e te rriturit/150 muaj

- Formula Young

Femije 1-12 vjec = mosha e femijes ne vite x dozen e te rriturit/moshen e femijes ne vite+12

- Formula Clark

Doza e femijes = pesha e femijes ne kg x dozen e te rriturit / 70 kg

- Formula qe merr per baze sipërfaqen trupore

Doza e femijes = sipërfaqja trupore e femijes(ne m²) x dozen e te rriturit/ 1.73

Tema 4. Kujdesi ne perdorimin e barnave

Personeli infermieror duhet te kete njohuri per medikamentet, veprimet, perdorimet dhe efektet anesore te tyre, kujdesin gjate perdorimit etj. Personeli shendetesor do te pergatise dhe do te perdore medikamentet prandaj ka pergjegjesi per keto veprime.

Pergatitja e barnave per perdorim

1. Urdhri i mjekut per perdorimin e barnave duhet te jete i shkruar. Ketu ben perjashtim vetem urgjenca, ku infermieri mund te perdore barnin edhe me urdher verbal, megjithate mjeku duhet ta shkruaje kete urdher sa me shpejt.
2. Urdhri me shkrim i mjekut duhet te ruhet.
3. Urdhri qe eshte i paqarte duhet te sqarohet.
4. Etiketa e medikamentit te kontrollohet nje here kur merret na dollapi, para se te nxirret nga mbajtesja dhe para se te rikthehet ne dollap.
5. Medikamenti nuk duhet perdorur nese etiketa e tyre mungon ose nuk eshte e qarte.
6. Duart duhet te lahen perpara pergatitjes se barit per perdorim.
7. Tabletatat dhe kapsulat nuk duhen kapur me dore.
8. Te kontrollohet steriliteti i shiringave.
9. Barnat qe kerkojne vend special per ruajtje si frigorifer apo ambient te erret, te kthehen menjehere pas perdorimit ne vendin e tyre te pershtatshem.
10. Asnjehere te mos perdoren medikamentet qe i ka pergatitur dikush tjeter me pare.
11. Te mos perdoren medikamentet qe u ka kaluar data e skadences, apo jane cgjyrosur.
12. Te respektohen pese rregullat D (doza e duhur, pacienti i duhur, medikamenti i duhur, koha e duhur, menyra e duhur.

Tema 5. Rruget e marrjes se barnave

Perthitje quhet procesi i kalimit te barit nga vendi ku aplikohet bari, deri ne gjakun sistemik.

Vendi i aplikimit quhet sipërfaqja e organizmit e cila bie fillimisht në kontakt me barin e dhënë. Kjo varet nga rruga e marrjes së barit. Zgjedhja e rruges së dhënies së barit ndikohet nga shumë faktore siç është lloji i efektit të dëshiruar, sistematik apo lokal.

Rrugët që përdoren për të futur barin në organizëm ndahen në:

- A) Rruga natyrore
- Rruga sublinguale
 - Rruga orale
 - Rruga rektale
 - Rruga respiratore
 - Lekura
 - Mukozat

Rrugët natyrore janë rruga ekzistuese dhe aplikimi i barit në këto rruga nuk është i vështirë për tu përdorur nga i sëmurë.

- B) Rruga artificiale
- Rruga intravenoze
 - Rruga intraarteriale
 - Rruga subkutane
 - Rruga intramuskulare
 - Rruga intrakavitare

Kjo mënyrë aplikimi shfrytëzon një rruga e cila nuk ekziston normalisht, e cila hapet në mënyrë invazive duke përdorur mjete të posaçme (agje, kateter). Dhënia e barnave me këto rruga kërkon personel të kualifikuar.

Rruga orale është rruga më e përdorshme për marrjen e medikamentit sepse është më e thjeshtë, më e sigurtë, më e lehtë për përdorim nga pacienti, më ekonomike dhe më pak e rrezikshme (në rast mbidozimi preparati mund të largohet nga stomaku duke i provokuar të vjella pacientit ose me lavazh nga stomaku). Kjo rruga nuk mund të përdoret kur i sëmurë është në gjendje kome.

Rruga sublinguale nuk përdoret shpesh por është e rëndësishme në rast se duam të marrim një efekt të shpejtë të barit sepse shtresa e nëngjuhes nuk ka shtresë korneale dhe është shumë e vaskularizuar. Medikamenti që thithet derdhet direkt në deget e venës kava superior, derdhet direkt në zemer, prandaj efekti është i shpejtë.

Rruga rektale përdoret për format farmaceutike si supostatet dhe klizmat.

Rruga inhalatore përdoret zakonisht për efektet lokale por mund të përdoret në disa raste edhe për efekte të përgjithshme.

Lekura (rruga transdermale) ka të bëjë me vendosjen e pllakave që ngjiten në lekure

Rruga subkutane. Në këto rast injektimi i barit bëhet nëndermjet lekures dhe muskulit. Thithja e barit me këto rruga është e ngadalte.

Rruga intramuskulare. Muskujt jane shume te vaskularizuar prandaj me kete rruge barnat perthithen shume me shpejt se me rrugen subkutane. Injektimi intramuscular eshte pak I dhimbshem sepse ne muskuj ka pak fije nervore.

Rruga intravenoze. Ne kete rruge, me ane te venes, bari futet direkt ne gjak.

Rruga intradermale perdoret zakonisht per te vleresuar sensibilitetin e organizmit (psh testi i tuberkulines), testet kutane te alergjise etj.

Rruga intraarteriale perdoret rralle psh per zgjerimin e arteries femorale, per kimioterapine lokale te kancerit etj.

Tema 6. Shperndarja dhe metabolizimi i barnave ne organizem

Pas thithjes medikamentet arrijne ne gjak. Ketu ato pjeserisht lidhen me proteinat plazmatike prandaj ato ne plazme gjenden pjeserisht te lira dhe pjeserisht te lidhura me proteinat plazmatike. Medikamentet qe lidhen pak me proteinat plazmatike kane efekt me te shpejte, me te fuqishem dhe me te shkurter. Preparatet qe lidhen shume me proteinat plazmatike kane efekt me te ngadalshem, me te dobet dhe me te zgjatur. Midis dy formave ne cdo moment ka nje ekuiliber dinamik. Kur bari i lire eliminohet atehere nje pjese e barit i lidhur do te clirohet per te ruajtur ekuilibrin.

Metabolizimi i barnave ne organizem

Efektet farmakodinamike te barnave jane te kufizuara ne kohe sepse ato mund ti nenshtrohen biotransformimit. Organi kryesor i biotransformimit te barnave(metabolizimit) te barnave eshte melcia. Medikamentet metabolizohen ne dy faza :

- Faza e pare (jo sintetike) ne te cilen zhvillohen procesi i oksidimit, reduktimit dhe hidrolizes.
- Faza e dyte (sintetike) gjate te ciles barnat bashkohen me nje substrat endogjen.

Rezultati i ketyre ndryshimeve eshte inaktivizimi i barnave si dhe rritja e hidrosolubilitetit te tyre me qellim qe te eliminohen me shpejt nga organizmi. Shkalla e metabolizimit te barnave ne organizem eshte e ndryshme ne individe te ndryshem. Kjo varet nga :

- Mosha
- Gjendja patologjike
- Konstitucioni gjenetik
- Bashkeveprimet midis medikamenteve te ndryshme

Tema 7. Eleminimi i barnave ne organizem

Rruga kryesore e ekskretimit te barnave eshte rruga renale. Pervec kesaj ekzistojne edhe rruge te tjera te cilat do ti permendim me poshte.

Ekskretimi me veshka eshte pasoje e tre proceseve :

1. Filtrimit glomerular
2. Sekretimit tubular
3. Ripërthithjes tubulare

Ekskretimi me rruge biliare dhe fece

Bari qe gjendet ne fece mund ta kete origjinen ose nga pjesa e papërthithur e barit te marre nga goja ose nga bari qe eksretohet me bile dhe qe nuk ripërthithet nga intestine.

Ekskretimi me peshtyme

Paraqet rendesi praktike vetem per matjen e përqendrimit te atyre barnave te cilat kane përqendrime te ngjashme midis plazmes dhe peshtymes.

Ekskretimi me qumesht

Ekskretimi me qumesht eshte i përendesishem per nenen, por shume i rëndesishem per femijen qe merr gjirin e saj, pasi ne qumesht barnat e pajonizuara dhe teper te tretshem ne yndyrna arrijne përqendrime te ngjashme me ato te plazmes.

Ekstretimi me pulmone

Ekskretimi me rruget e frymemarrjes ka rendesi per eliminimin e anestetikeve te pergjithshem te gazte.

Tema 8. Faktoret qe ndikojne ne efektin e barit

Shfaqja e efektit farmakologjik te barnave, si dhe intensiteti i veprimit te barnave, varen nga nje sere faktoresh. Keta faktore ndahen ne tre grupe :

A) Faktore te lidhur me barin

- Doza eshte nje nga faktoret kryesore. Me doze kuptojme sasine e barit te futur ne organizem.
- Përqendrimi eshte nje faktor tjetër. Përqendrimet e larta favorizojne nje thithje me te shpejte te barit dhe kjo detyrimisht do te reflektohet ne forcen e efektit te barit dhe e kunderta.
- Forma farmaceutike e barit do te ndikojne ne shkallen e tretshmerise dhe ne efektin e tij.
- Gjendja fiziko-kimike gjithashtu ndikon ne shpejtesine e përtithjes.

B) Faktoret e lidhur me organizmin

- Moshë eshte nje nga faktoret kryesore qe ndikon ne efektin e barit. Organizmi i femijes ndryshon nga i rrituri jo vetem persa i perket permasave trupore por edhe reagimit te ndryshem te tij ndaj disa barnave.
- Seksi. Per shume arsye te veprimtarise fiziologjike te organizmit te gruas, gjate periudhave te ndryshme rritet ndjeshmeria ndaj nje sere barnash.
- Morfotipi. Barnat liposolubile fiksohen me shumice ne indin dhjamor te nen lekures prandaj ne varesi te variacioneve individuale te ketyre depozitave dhjamore, do te

ndryshoje sasia e barit qe eshte ne gjendje te lire ne gjak dhe per rrjedhoje edhe efekti farmakologjik.

- Konstitucioni gjenetik. Mungesa e lindur e enzimave te ndryshme do te reflektohet ne efektin e barnave qe i kane te domosdoshme keto enzima per tu transformuar.
- Gjendja funksionale e organizmit ka rendesi sidomos per funksionin e melcise dhe veshkave.
- Gjendja patologjike. Shfaqja e efektit te nje bari ne organizem mund te kushtezohet nga prania ose jo e gjendjes patologjike.
- Ritmi biologjik. Per arsye te paqarta funksionet e organizmit pesojne variacione ciklike ne kohe, qe perbejne ritmet biologjike. Keto fenomene shpjegojne faktin qe nje bar i dhene ne momente te ndryshme te dites nuk jep te njejtin efekt.
- Rruget e marrjes. Ne varesi te rruges se marrjes se barnave do te percaktohet jo vetem shpejtesia e shfaqjes se efektit te barit, por ne disa raste ajo mund te percaktoje nese do te shfaqet efekti apo jo.
- Rruget e ekskretimit. Ne varesi te rruges se ekskretimit do te varet edhe mundesia qe nje bar te tregojte efekt ose jo.

C) Faktore te jashtem (mjedisore)

- Presioni atmosferik\
- Temperatura
- Ushqimi

Tema 9. Barnat me efekt ne qarkullimin e gjakut dhe zemer



Kardiotoniket

Kardiotonike quhen substancat qe rrisin fuqine tkurrese te muskulit te zemres. Sipas mekanizmit te tyre dhe sipas origjines se tyre ato ndahen ne dy grupe:

1. Kardiotoniket glukozidike
2. Kardiotoniket jo glukozidike

Glukozidet kardiake jane barna me prejardhje bimore qe veprojne ne menyre perzgjedhese mbi muskulin e zemres duke rritur fuqine tkurrese te tij. Ne kete grup bejne pjese **digoksina** dhe **digitoksina**. Pas thithjes ne gjak digitoksina lidhet me proteinat plazmatike ne masen 95% kurse digoksina ne masen 25%.

Efektet farmakologjike te glukozideve kardiake :

- Efekt inotrop pozitiv (rritja e fuqise tkurrese te muskulit te zemres)
- Efekt kromotrop negativ (shkaktone rrallimin e te rrahurave te zemres)
- Efekt dromotrop negativ (ngadaleson percjellshmerine e kalimit te impulsit nga atriumet per ne ventrikuj)
- Efekt batmotrop pozitiv (rrit ndjeshmerine e muskulit te zemres)

Tek pacientet me insuficiene kardiake funksioni pompe i zemres eshte i demtuar dhe per kete arsye ulet sasia e gjakut qe hedh zemra ne aorte. Per pasoje ulet furnizimi me gjak i organeve te ndryshme. Glukozidet kardiake duke rritur forcen tkurrese te muskulit te zemres, rivendosin funksionin pompe te saj dhe furnizojne me mire me gjak te gjitha indet.

Indikimet e glukozideve kardiake :

- Insuficiene kardiake akute dhe kronike
- Takikardi paroksizmale supraventrikulare
- Flater atrial
- Fibrilacion atrial

Kardiotoniket jo digitalike ndahen ne dy grupe :

- Adrenomimetiket
- Frenuesit e fosfodiesterazes

Adrenomimetiket jane barnat qe imitojne efektet e nxitjes se sistemit nervor simpatik. Ne kete grup bejne pjese epinefrina (adrenalina), norepinefrina (noradrenalina) dhe dopamine qe prodhohen ne menyre natyrore si dhe barna te tjera te perftuara sintetikisht si izoproterenoli, dobutamina, metaraminoli, efedrina etj.

Efektet farmakologjike jane te shumta : Nxitje te sistemit nervor, pagjumesi, vazokonstriksion, rrisin ndjeshmerine e muskulit te zemres, zgjerim te bronkeve, ulin veprimtarine prodhuese te gjendrave me sekrecion te jashtem etj.

Indikimet

- Hypotension
- Bradikardi
- Arrest kardiak
- Krizat e astmes bronkiale
- Alergjite e ndryshme etj.

Ne grupin e frenuesve te fosfodiesterazes bejne pjese amrinoni, milrinoni, enoximoni. Keto preparate veprojne duke frenuar enzimen fosfodiesteraze, per pasoje rrisin nivelin e AMP ciklike dhe kjo con ne zgjerimin e eneve te gjakut.

Indikohen :

- Insuficiencia kardiake kongjестive akute

Antiaritmiket

Aritmite jane crregullim i ritmit normal sinusal te zemres, qe shfaqet si crregullim i frekuences ose i vendit te lindjes se impulsit. Ato lindin si rezultat I prishjes se automatizmit, percueshmerise ose nga kombinimi I tyre.

Antiaritmiket jane barna qe perdoren per mjekimin e turbullimeve te ritmit te zemres. Ketu bejne pjese kinidina, prokainamidi, disopiramidi, lidokaina, propranololi, verapamili, amiodarone etj,

Efektet farmakologjike :

Muskulatura e zemres (miokardi) ka cilesite edhe te muskulit por edhe te nervit. Antiaritmiket veprojne duke frenuar eksitabilitetin (ndjeshmerine) e miokardit, pra frenojne aftesine per t'ju pergjigjur stimujve elektrike. Antiaritmiket veprojne edhe duke zgjatur periudhen refraktare (periudhen e pushimit) te kalimit te impulsit neper miokard. Antiaritmiket duke zgjatur periudhen refraktare ulin numrin e impulseve qe kalojne ne nje kohe te caktuar, pra ulin numrin e rrahjeve te zemres ne minute.

Indikimet :

- Kinidina perdoret ne mjekimin e aritmive atriale, ekstrasistolave, fibrilacionit dhe flaterit atrial, si dhe ne aritmite ventrikulare.
- Lidokaina perdoret vetem ne aritmite ventrikulare.
- Difedani preferohet ne aritmite e shkaktuara nga helmimi me digitalike.
- Verapamili perdoret ne aritmite supraventrikulare.
- Amiodaroni preferohet ne aritmite ventrikulare.

Antianginozet

Angina pectoris ose ndryshe insuficiencia koronare eshte pamundesia e koronareve per te perballuar kerkesat e miokardit per oksigjen. Kjo ndodh per shkak te ngushtimit te koronareve me pllaka arteriosklerotike ose sepse koronaret pesojne spazme te perkoshme. Kjo gjendje manifestohet me dhimbje shtrenguese, renduese apo djegese ne regjionin pektoral e qe mund te irridohet ne krahun e majte, aritmi, ndryshime ne ECG deri ne infarkt akut te miokardit.

Trajtimi medikamentoz i insuficiences koronare behet me preparate qe veprojne ose duke zgjeruar arteriet koronare ose duke ulur kerkesat e miokardit per oksigjen. Ne varesi te mekanizmit te veprimit preparatet antianginoze ndahen ne 3 grupe :

1. Nitratat dhe nitritet organike (nitroglicerina, izosorbit dinitrati)
2. Kalcibllokuesit (nifedipina, verapamili, diltiazemi)
3. Betabllokuesit (propranololi, atenololi etj)

Nitratat veprojnë direkt në muskulaturën e lemuar duke e relaksuar atë. Ato zgjerojnë si arteriet, venat dhe kapilaret. Meqë zgjerojnë të gjitha enët shkaktojnë ulje të presionit arterial e venoz gjë që shoqërohet me ulje të punës së zemrës, me ulje të konsumit të oksigjenit nga ana e muskulit të zemrës. Nitrodilatatorët lirojnë edhe muskulaturën e zgjeruar të bronkeve, traktit gastrointestinal dhe atij urogenital.

Indikimet për nitratat :

- Parandalimi i krizës anginoze (izosorbit dinitrati)
- Mjekimi i krizës anginoze (nitroglicerina)
- Në trajtimin e infarktit të miokardit
- Në trajtimin e krizës hipertensive, spazmave biliare dhe ezofageale.

Kalcibllokuesit përfaqësojnë një grup të rëndësishëm të barnave që përdoren në trajtimin mbajtës të sëmurëve me ishemi koronare, hipertension arterial dhe çrregullimet e ritmit të zemrës. Në këtë grup bëjnë pjesë verapamili, nifedipina, amlodipina, nikardipina, nimodipina, diltiazemi etj. Dihet që kalciumi luan një rol të rëndësishëm në potencialin e veprimit. Futja e kalciumit në qelizë rrit fuqinë tkurresë dhe eksitabilitetin e saj. Kalcibllokuesit duke penguar levizjen e neper membrane tregojnë veprim vazodilatator dhe për pasoje ulin presionin e gjakut.

Indikimet për kalcibllokuesit :

- Parandalimi i krizës anginoze
- Mjekimi mbajtës i hipertensionit
- Përdoren edhe si antiaritmike (verapamili dhe diltiazemi)

Betabllokuesit janë preparate që përdoren për trajtim mbajtës të sëmurëve me angor të efortit. Ky grup preparatesh vepron mbi receptoret beta 1 të zemrës duke ulur punën e saj dhe për pasoje ulin kërkesat e miokardit për oksigjen. Gjithashtu kanë efekt antihipertensiv dhe antiaritmik.

Indikimet për betabllokuesit :

- Parandalimi i angorit të efortit;
- Hipertoni ;
- Takikardi.

Diuretiket

Diuretike quhen substanca që shkaktojnë eliminimin e ujit dhe elektroliteve nga organizmi nepermjet urines. Diuretiket ndahen në disa grupe :

1. Frenuesit e anhidrazes karbonike;
2. Diuretiket osmotike;
3. Tiazidiket;
4. Diuretiket e Hanses;
5. Antagonistet e aldosteronit.

Shumica e diuretikeve veprojnë duke penguar perthithjen e natriumit në sektore të ndryshme të tubulave renale. Për sa i përket filtrimit glomerular me përjashtim të diuretikeve të Hanses si dhe diuretikeve osmotike që e rrisin, të tjerët veprojnë duke e ulur atë.

Indikimet :

- Frenuesit e anhidrazes karbonike përdoren në okulistike për trajtimin e glaukomes me kënd të gjere, në trajtimin paraoperator të glaukomes akute me kënd të ngushtë si dhe në trajtimin e edemave të ndryshme apo në disa forma të epilepsisë.
- Diuretiket osmotike përdoren për parandalimin dhe mjekimin e fazës oligurike të insuficiencës renale në glaukome dhe në edemat cerebrale.
- Diuretiket tiazidike janë diuretiket më të përdorshëm sepse tolerohen mirë dhe kanë veprim të mirë. Përdoren në edemat e ndryshme kardiake, hepatike dhe renale si dhe në trajtimin e hipertensionit.
- Diuretiket e Hanses janë diuretiket më të fuqishëm prandaj preferohen në urgjencën hipertensive, edemat e theksuara renale, hepatike, kardiake, edemën pulmonare si dhe në rastet helmimesh.
- Antagonistet e aldosteronit përdoren në trajtimin mbajtës të hipertensionit, edemat hepatike, kardiake, sindromin nefrotik.

Antihipertensivët


Antihipertensive quhen substancat që përdoren për trajtimin e sëmundjes së hipertensionit (hipertensionit). Kufiri normal i presionit arterial për të rriturit është 120/80 mmHg. Në rastin e hipertensionit mund të rritet mbi këtë vlerë presioni maksimal, minimal ose të dy së bashku. Në varësi të vendit dhe mekanizmit të veprimit i klasifikojmë në 5 grupe:

1. Diuretiket
 - Tiazidiket (hidrokloriazidi)
 - Antagonistet e aldosteronit (spironolaktoni, triamtereni, amilorida)
 - Diuretiket e Hanses (furosemidi)
2. Simpatolitiket
 - Simpatolitiket qendrore (klonidina, metildopa)
 - Simpatolitiket periferike (prazosina, propranololi, atenololi)
3. Substancat që veprojnë drejtpërdrejt në enët e gjakut (hidralazina, nitroprusidi I natriumit, nifedipina, verapamili etj)
4. Frenuesit e sistemit renine-angiotenzine (enalapriili, kaptopriili, losartan)
5. Bimet me veprim antihipertensiv.

Zgjedhja e antihipertensiveve

Mjekimi i hipertoniqeve mund të jetë i ngjashëm por jo i njëjtit për të gjithë të sëmurët. Zgjedhja e njerit apo tjetrit preparat bëhet në varesë të moshës, sëmundjeve të tjera shoqëruese të të sëmurit si dhe në bazë të reagimit individual. Në hipertensionin rezistent mund të bëhen kombinime midis antihipertensiveve të ndryshme. Gjate trajtimit të hipertensionit duhet luftuar edhe ndaj gjithë faktorëve të tjere riskante. Në dietën e hipertonicit duhet kufizuar kripa, të menjaherë përdorimi i duhanit, të mjekohen dislipidemia, diabeti etj. Për trajtimin e krizës hipertensive në kushte spitalore, më i përshkaktshëm është nitroprusidi i natriumit dhe diazoksidi të cilat përdoren në rrugë venoze duke e monitoruar të sëmurin. Preparate të tjera që mund të përdoren edhe në kushte ambulatorie me rrugë venoze janë furosemidi, sulfati i magnezit, metildopa, fentolamina, trimetofani etj.

Tema 10. Barnat me efekt në traktin e frymëmarrjes



Histamina dhe antihistaminiket

Histamina është një substancë e pranishme në inde të ndryshme të organizmit si në melci, mushkeri, zorrë dhe lëkurë. Përqendrimet më të larta të saj gjenden në qelizat bazofile (një lloj i qelizave të bardha të gjakut) dhe në mastocidet (qelizat që gjenden afër kapilarëve). Histamina prodhohet në përgjigje të një dëmtimi indor. Në bronke histamina vepron duke ngushtuar ato, ndërsa në stomak rrit sekretimin e acidit klorhidrik. Efektet e histaminës në muskulaturën e enëve të gjakut dhe bronket i dedikohet veprimit mbi receptoret H₁, ndërsa efektet në stomak i dedikohen veprimit mbi receptorët H₂.

Preparatet që bllokojnë receptorët H duke mos lejuar bashkëveprimin e tyre me histaminën quhen antihistaminike. Antihistaminikët në varësi të receptorëve me të cilët bashkeveprojnë ndahen në dy grupe :

antihistaminik

1. Antihistaminikët H₁ (që përdoren si antialergjikë)
2. Antihistaminikët H₂ (që përdoren si antiulceroze)

Bronkodilatatorët

Bronkodilatatorët janë preparate që veprojnë duke larguar bronkospazmat të cilat janë përgjegjëse për crregullimet respiratore në sëmundjet e astmës bronkiale, bronkitet kronike dhe emfizemës. Bronkodilatatorët sipas mekanizmit të veprimit ndahen në disa grupe :

1. Simpatomimetikët (salbutamoli, terbutalina, salmeteroli, rimiteroli etj)
2. Ksantinat (teofilina, aminofilina)
3. Kolinolitikët (ipratropium)
4. Kortizonikët

Simpatomimetikët përdoren në trajtimin e astmës bronkiale (si për trajtimin e krizës, edhe për trajtim mbajtës), sëmundjet kronike obstructive pulmonare, apnenë e prematurëve.

Ksantinat përdoren për trajtimin e astmës bronkiale kur përdorimi i simpatomimetikëve është i pamjaftueshëm. Ato përdoren si për trajtimin e krizes astmatike edhe pr trajtimin e krizes astmatike edhe për trajtim mbajtës të saj, si dhe në sëmundjet kronike obstructive pulmonare.

Kolinolitikët përdoren si terapi plotësuese kur ka dsuese kur ka dështuar mjekimi vetem me betamimetiket.

Barna që parandalojnë bronkospazmën (kromoglukati i natriumit)

Kromoglukati i natriumit ne dallim nga bronkodilatatorët, nuk heqin dot bronkospazmën por vepron vetëm duke parandaluar shfaqjen e bronkospazmës si dhe reaksioneve të tjera alergjike. Ai vepron në mastocitet duke penguar clirimin e histamines dhe hormoneve te tjera lokale që janë përgjegjëse për gjithë kuadrin klinik të reaksioneve alergjike.

Kromoglukati i natriumit (kromolina) përdoret për profilaksinë (parandalimin) e astmës bronkiale, trajtimin profilaktik të riniteve alergjike, konjuktiviteve alergjike apo alergjive të aparatit tretës.

Antitusivët

Kolla është një mekanizëm i rëndesishëm fiziologjik mbrojtës për të larguar trupat e huaj apo produktet terminale të inflamacionit nga hapësira e traktit respirator. Ajo fillon të bëhet shqetësuese për të sëmurin duke crregulluar frymëmarrjen e duke dhënë dipne. Për këtë arsye përdoren barnat kundër kollës ose ndryshe te quajtura barna antitussive. Në frenuesit e kollës bëjnë pjesë dekstrometorfani, folkodina, kodeina dhe difenhidramina.

Këto preparate veprojnë në qëndrën e kollës duke e frenuar atë. Dekstrometorfani dhe folkodina kanë më pak efekte anësore se kodeina. Por nga ana tjetër ato nuk janë efektive ndaj shperthimeve të fuqishme të kollës ku kodeina vazhdon të jetë efektive.

Antitusivët përdoren për mjekimin e kollës së thatë dhe nuk këshillohen të përdoren në kollën e njomë (me sputum). Difenhidramina preferohet sidomos kur kollja është pasojë e sekrecioneve nazale. Kur kollja është rebele (ne kancerin bronkial) dhe nuk qetësohet nga barnat e mesipërme mund të mbetet si zgjidhje e vetme përdorimi i morfinës.

Mukolitikët dhe ekspektorantët

Mukolitikë dhe ekspektorantë janë barna që hollojnë sekrecionet respiratore dhe ndihmojnë nxjerrjen e sputumit nga rrugët respiratore. Në grupin e mukolitikëve bëjnë pjesë acetilcisteina, bromheksina, karbocisteina ndërsa në grupin e ekspektoranteve bëjnë pjesë kriprat klasike si joduri i kaliumit, joduri i natriumit, acetati i amonit, ipekakuana dhe guainfenesina.

Mukolitikët ndikojnë duke ulur përmbajtjen e mucinës në sekrecionet respiratore kështu që duke ulur viskozitetin e sputumit lehtëson nxjerrjen e tij me anë të kollës. Acetilcisteina përveç këtij efekti sillet edhe si antidod në helmimet nga paracetamoli.

Ekspektorantët veprojnë duke rritur prodhimin e sekrecioneve seroze bronkiale dhe duke holluar përmbajtjen e mucinës, lehtësojnë nxjerrjen e sputumit me anë të kolles.

Mukolitikët përdoren si terapi plotësuese në bronkopneumoni, emfizemë si dhe në parandalimin e dëmtimeve hepatoke kur përdorim lëndët toksike (paracetamol).

Ekspektorantët përdoren për të ndihmuar daljen e sekrecioneve respiratore në sëmundjet pulmonare kronike me sputum.

Tema 11. Barnat me efekt në sistemin nervor



Barnat sedativo-gjumëdhënëse

Me termin bar sedativ kuptojmë atë bar (ose atë dozë të barit) të aftë të qetësojë të sëmurin pa shkaktuar gjumë tek ai. Ato përdoren gjatë ditës por krahas qetësimit ato mund të japin një gjendje dremitje.

Me termin bar gjumëdhënës (hipnotik) kuptojmë atë bar (apo atë doze bari) që tek personat që vuajnë nga pagjumësia (apo crregullime të gjumit) është i aftë të induktojë një gjumë të ngjashëm me gjumin fiziologjik.

Klasifikimi i barnave sedativo-gjumëdhënëse

- A) Benzodiazepinat (nitrazepam, triazolam, temazepam, diazepam etj)
- B) Imidazopirinat (zopidem) dhe Ciklopirolonet (zopiclon)
- C) Barbiturate
- D) Barnat sedative-gjumëdhënëse me strukturë të ndryshme
- E) Antihistaminikët H1 (promethazina).

Benzodiazepinat në doza të vogla tregojnë vetëm efekt sedativ (qetësues e relaksues) dhe efekt anksiolitik (largojnë ankthin). Me rritjen e dozës shfaqet efekti gjumëdhënës i cili mund te qojë deri në gjendje stupori por pa shkaktuar frenim të plotë të SNQ. Përdorimi i tyre më gjatë se 1-2 javë con në zhvillimin e tolerancës. Toleranca (ulja e përgjigjes ndaj një bari nga marrja e përsëritur) si një shfaqje e zakonshme ndaj sedativo-hypnotikëve, kërkon që për të marrë efektin gjumëdhënës, duhet rritur doza. Benzodiazepinat përvec efektit sedativ, gjumëdhënës, anksiolitik kanë edhe veprim myorelaksant dhe antikonvulsiv. Dozat e larta shoqërohen me ulje të presionit arterial dhe rritje t presionit arterial dhe rritje të frekuencës kardiake.

Barbituratet (të gjitha preparatet) kanë të njëjtat efekte. Në varësi nga doza ato duke frenuar SNQ japin fillimisht efekt sedativ dhe me rritjen e dozës efekt gjumëdhënës, narkotik deri komë të thellë. Këto substanca janë frenues të theksuara të frymëmarrjes dhe me doza toksike mund të rrezikojnë edhe jetën. Përdorimi i zgjatur i tyre favorizon për zhvillimin e gjëndjes së psikozës dhe krijon një farë vartësie ndaj këtyre barnave. Për shkak të toksicitetit të lartë ky grup preparatesh për efektin gjumëdhënës përdoren më rrallë.

Zolpidem jep efekt sedativ më të fuqishëm se benzodiazepinat por tregon efekt antikonvulsiv më të dobët dhe jep më pak efekte anesore. Përdoren për trajtimin afat shkurtër te pagjumësive. **Zopiklon** ka efekte të ngjashme me benzodiazepinat, nuk jep gjëndjen e përgjumjes të nesërmen e përdorimit, nuk jep gjëndjen e dependences prandaj edhe ndërprerja e mjekimit është më e lehtë dhe më e sigurve.

Barnat sedativo-gjumëdhënëse me strukture të ndryshme. Në këtë grup bëjnë pjesë paraldehida, kloralhidрати, glutetimidi, meprobamati etj. Me përjashtim të meprobamatit veprimet farmakologjike të barnave të tjera ngjasojnë me barbituratet.

Antihistaminikët H1. Prometazina është një gjumëdhënës me veprim të gjatë dhe përdoret më tepër në pagjumësitë tek fëmijët.

Barnat antikonvulsive

Krizë konvulsive është term që përdoret për të përshkruar konvulsionet që kanë një shkak të njohur. Këtu futen krizat që shkaktohen nga temperatura e lartë, crregullimet elektrolitike, uremia, tumoret e trurit dhe hypoglicemite e rënda. Me tu larguar shkakut I krizes edhe ajo ndërpritet.

Epilepsia nënkupton një crregullim të funksionit cerebral që karakterizohet nga atake konvulsive periodike dhe të paparashikueshme të cilat në varësi të lokalizimit të vatrës epileptike dhe të shtrirjes së këtij dëmtimi neurologjik mund të shoqërohen edhe me dëmtime të funksioneve sensore, vegjetative dhe psikike.

Barnat që përdoren për trajtimin e crregullimeve konvulsive quhen antikonvulsivë. Grupet kryesore të preparateve antikonvulsive janë :

1. Barbituratet dhe deoksibarbituratet (metabarbitali, fenobarbitali, metobarbitali etj)
2. Hidantoinat (fenitona)
3. Iminostilbenet (karbamazepina)
4. Benzodiazepinat (diazepami, lorazepami, etj)
5. Acidi valproik
6. Oksazolidinedionet (trimetadoni)
7. Suksimidet (etosuksimidi)
8. Antiepileptikët e rinj (gabapetina, lamotrigine, felbamat etj)

Në përgjithësi antikonvulsivët veprojnë duke ulur eksitabilitetin e neuroneve (qelizave nervore) të trurit. Kur eksitabiliteti i neuroneve ulet, krizat konvulsive reduktohen si në intensitet, shpeshësi dhe kohëzgjatje ose në disa raste ato edhe largohen plotësisht. Në disa të sëmurë me anë të preparateve antikonvulsive mundësohet vetëm pjesërisht kontrolli i krizave konvulsive.

Indikimet :

- Trajtimi i grand mal epilepsisë ;
- Trajtimi i petit mal epilepsisë ;

Mjekimi i statusit epileptik

Statusi epileptik përbën një urgjencë mjekësore. Mjekimi i zgjedhur bëhet me diazepam 20-30 mg IV, efekti i të cilit zgjat të paktën 30-40 min, kohe gjatë të cilës fillohet mjekimi me fenitoinë. Kur vena nuk gjendet një rrugë e shpejtë është futja në rektum me mikroklizmë I diazepamit. Injektimi në muskul është I papershtatshëm I papershtatshëm sepse thithja është e ngadalshme. Një alternativë tjetër është fenobarbitali I cili jepet IV me dozë 100-200 mg pa kaluar dozën 400-800 mg. Në rastet rezistente mund të përdoret deri anestezia e përgjithshme.

Antiparkinsonikët

Sëmundja e parkinsonit karakterizohet me dridhje, rigiditet nmundja e parkinsonit karakterizohet me dridhje, rigiditet në disa grupe muskujsh dhe dobësi të muskujve të tjere. Kjo është pasojë e mungesës së dopaminës (DA) dhe tepricës së acetilkolinës (Ach) në zonën nigro-striate të SNQ.

Sindromi parkinsonian është term që përdoret për rastet kur si pasojë e përdorimit të disa barnave (psh neuroleptikët), encefalitit ose disa dëmtimeve të kokës shfaqen shenja të ngjashme me sëmundjen e parkinsonit. Preparatet antiparkinsonike kanë për qëllim të korigjojnë ekuilibrin e prishur midis DA dhe Ach. Në varësi të mekanizmit të tyre barnat antiparkinsonike i ndajmë në tri grupe :

1. Zëvendësuesit e dopaminës (Levodopa)

Meqënëse simptomat e sëmundjes së parkinsonit vijnë si pasojë e mungesës së dopaminës, zëvendësimi i saj do të ishte mjekimi specifik. Meqënëse dopamina nuk e kalon barrieren hemato-encefalike, në vend të saj përdorim levodopën (paraardhësin e dopaminës) e cila kalon pjesërisht në tru dhe aty pasi transformohet në dopaminë tregon efektin farmakologjik.

2. Barnat dopaminergjike (amantadina, bromokriptina, pergolina).

Amantadine vepron duke nxitur neuronet e dopaminës që të prodhojnë sa më shumë dopamine. Ajo ka efekt në format e lehta të parkinsonit. Bromokriptina dhe pergolina veprojnë si nxitëse të receptorëve dopaminergjik në regjionin striat.

3. Kolinolitikët qëndrorë (triheksifenidili)

Kolinolitikët qëndrorë duke bllokuar receptorët e acetilkolinës favorizojnë rivendosjen e ekuilibrit midis dopaminës dhe acetilkolinës.

Indikimet e antiparkinsonikëve :

- Përdoren në trajtimin e sëmundjes së parkinsonit. Ato mund të përdoren vecmas duke e rritur dozën gradualisht, me qëllim që të gjendet doza më e pershtatshme. Në rast nevojë mund të kombinohen midis tyre me qëllim që të merret efekt sa më I mire mesa më pak efekte anësore.

Antidepresivet

Depresioni është një nga crregullimet psiqike më të zakonshme. Në gjendjet depressive mendohet se ka mungesë të neurotransmetuesve NA (noradrenalinë) DA (dopamine) dhe serotoninës në tru. Barnat antidepresive veprojnë duke rritur nivelin e DA, NA dhe serotoninës në tru.

Klasifikimi i antidepresivëve :

1. Antidepresivët triciklikë (imipramina, amitriptilina, trimeprimina etj)

Në pacientët normal antidepresivët triciklikë kanë pak efekte. Ato, kur përdoren në doza të mëdha japin efekt sedative. Në të sëmurët me depresion ato largojnë indiferentizmin psiko-motor,

përmirësojnë humorin, përmirësojnë oreksin. Ky efekt është i ngadalshëm dhe shfaqet një-dy javë nga fillimi i mjekimit. Në fillim të mjekimit të gjithë antidepressivët largojnë gjumin paradoksal por me kohë ky efekt dobësohet dhe po të ndërpritet mjekimi sëmundja rishfaqet.

2. Antidepressivët atipikë

Në dallim nga preparatet e tjera antidepressive ato :

- Kanë më pak efekte anësore ;
 - Helmimet nga mbidoza janë më të lehta ;
 - Efekti antidepressiv shfaqet më shpejt ;
 - Veprojnë në rastet rezistente ndaj mjekimit me tricikliket ;
 - Efikasiteti i tyre është më i dobët por meqë kanë më pak efekte anësore lejojnë përdorimin e dozave më të mëdha.
- ## 3. Frenuesit e MAO-s (trinilcipramina, klorgylina etj)

Në pacientët normalë këto preparate rritin aktivitetin motor dhe japin pas disa ditësh eufori. Përdoren në rastet rezistente ndaj antidepressivëve triciklikë.

Indikimet e antidepressivëve :

- Në gjendjet depressive ;
- Në psikoza kronike ;
- Në neuroza obsesive ;
- Në dhimbjet kronike rebele kanceroze ;
- Në dhimbjet migrenoze ;
- Enuresis nokturna ;
- Parkinson.

Antipsikotikët

Antipsikotikët janë një grup barnash që përdoren për mjekimin e skizofrenisë, disa psikoza dhe gjëndjeve të axhituara. Ato quhen ndryshe edhe neuroleptikë.

Klasifikimi i antipsikotikëve :

1. Antipsikotikët tipikë
 - Fenotiazinat ;
 - Butirofenolet ;
 - Thioxantenet ;
 - Të ndryshme (loksapina, pimozidi)
2. Antipsikotikët atipikë (sulpiridi, risperidoli, klozapina, olanzapina)

Skizofrenia mendohet se është pasojë e crregullimit të transmetimit dopaminergjik në SNQ. Në rrugët mezo-limbike (rrugë që kontrollojnë sjelljen e pacientëve) transmetimi dopaminergjik është i ekzagjeruar, prandaj i sëmurit manifeston halucinacione, delire, crregullime të mendimit dhe axhitim. Këto preparate duke bllokuar receptorët dopaminergjik qendrorë largojnë këto shenja të psikoza.

Indikimet :

- Skizofreni ;
- Gjendjet maniakale ;
- Për kontrollin e crregullimeve të sjelljes në të sëmurët me Alzheimer ;
- Për qetësimin e të vjellave ;
- Si qetësues para operacionit ;
- Kundër pruritit në lëkurë etj.

Karbonati i Litiumit

Kriprat e litiumit megjithëse nuk futen në preparatet antipsikotike kanë disa përdorime të përbashkëta me to. Ato veprojnë duke rregulluar turbullimet e humorit dhe duke qetësuar të sëmurin me gjëndje maniakale. Preparatet tjera stabilizuese të humorit janë karbamazepina dhe acidi valproik.

Litiumi ndikon në përmirësimin e humorit të të sëmurit. Efekti i tij është i ngadalshëm prandaj në fillim duhet shoqëruar me barna antipsikotike dhe benzodiazepinat.

Indikimet :

- Profilaksi dhe mjekimin e gjëndjes maniakale ;
- Në crregullimet maniako-depresive ;

Barnat që nxitin sistemin nervor qendror

1. Analeptikët ku bëjnë pjesë doxaprami dhe niketamidi duke stimuluar qendrën e frymëmarrjes në medula oblongata shkaktojnë shpeshim të frymëmarrjes. Doksaprami përdoret për nxitjen e qendrës së frymëmarrjes në qoftëse ajo është e frenuar si në rastin e sëmundjeve kronike pulmonare dhe insuficiencën akute respiratore. Ajo gjithashtu përdoret në periudhën pas operatore kur si pasojë e anestezisë frenohet frymëmarrja. Niketamidi përdoret për të nxitur qendrën e frymëmarrjes kur ajo është e frenuar nga përdorimi i dozave të mëdha të substancave frenuese të SNQ.
2. Amfetaminat ku bëjnë pjesë amfetamina, dextroamfetamina dhe metamfetamina veprojnë në sistemin nervor qendror dhe si pasojë e nxitjes së tij shkaktojnë rritje të presionit arterial, shpeshim të pulsit. Ato gjithashtu duke vepruar në qendrën e oreksit në hipotalamus shkaktojnë ulje të oreksit. Amfetaminat mund të përdoren në kura të shkurtra në rastin e obezitetit ekzogjen. Ato përdoren në narkolepsi ose në sindromin e humbjes së vëmendjes të fëmijëve.
3. Anoreksigjenët ku bëjnë pjesë fendimetrazina dhe fentermina të cilat kanë veprim të ngjashëm me amfetaminat në uljen e oreksit. Këto preparate përdoren në kura të shkurtra në trajtimin e obezitetit ekzogjen.
4. Kofeina nxit SNQ në të gjitha nivelet përfshirë korteksin cerebral, medulën oblongata, medulën spinale. Ajo tregon veprim analeptik në qendrën e frymëmarrjes. Kofeina nxit gjithashtu edhe veprimtarinë e zemrës duke shkaktuar takikardi ndërsa në enët e gjakut në

përgjithësi shkakton zgjerim të tyre. Ajo nxit tkurrjen e muskulaturës të skeletit si dhe shton diurezën. Kofeina e përdorur në rrugë IM rekomandohet në rastet e frenimit të frymëmarrjes të shkaktuar nga përdorimi i substancave frenuese të SNQ si psh narkotikëve. Ajo përdoret edhe në insuficiencën akute cirkulatore dhe e kombinuar me ergotaminën përdoret në trajtimin e dhimbjeve migrenoze. Me rrugë orale kofeina e marrë qoftë edhe në formë pijesh përdoret nga mjaft individë për të larguar lodhjen.

Tema 12. Barnat me efekt në sistemin e tretjes



Antiulcerozët

Ulcera gastroduadenale sipas mendimit të shumë autorëve është pasojë e prishjes së ekuilibrit midis vetive agresive të HCL dhe pepsinës dhe faktorëve mbrojtës të mukozës së stomakut. Në të sëmurët me ulcera gastroduadenale është i shtuar prodhimi i HCL dhe janë të pakësuara mundësitë për zëvendësimin e shpejtë të qelizave epiteliale të dëmtuara. Barnat antiulceroze, sipas mekanizmit të veprimit të tyre ndahen në :

1. Barnat që pakësojnë sekretimin e acidit klorhidrik të stomakut.
 - Antagonistët e receptorëve H₂ të histamines (cimetidine, ranitidine, famotidine etj) ;
 - Frenuesit e pompës K/H-ATPazë (omeprazoli) ;
 - Kolinolitikët (pirenzepina)
2. Barna që neutralizojnë acidin klorhidrik të sekretuar nga stomaku.
 - Antiacidet alkalizues (hidrokarbonati i natriumit) ;
 - Antiacidet neutralizues (hidroksidi i aluminit, hidroksidi i magneziumit, karbonati i kalciumit) ;
3. Barnat që mbrojnë ose rritin fuqinë mbrojtëse të mukozës së stomakut (sukralfati, bismuthi koloidal, PG etj)

Barnat antisekretore përdoren për mjekimin e ulcerave duadenale aktive, ulcerat gastrike beninje, profilaksinë e ulcerave të shkaktuara nga stresi, si dhe në trajtimin e reflukseve gastroezofageale.

Frenuesit e pompës proteinike përdoren në ulcerën gastrike dhe duadenale, refluksin gastro-efozageal, sindromin Zollinger-Ellison.

Kolinolitikët veprojnë në mënyrë përzgjedhëse mbi receptorët M1 të stomakut dhe për pasojë frenojnë sekretimin e acidit klorhidrik. Zakonisht përdoren në dhimbjet natën.

Antiacidet janë substanca bazike të afta të neutralizojnë acidin klorhidrik të stomakut. Ato përdoren për trajtimin simptomatik të crregullimeve gastrointestinale të shoqëruara me hiperaciditetin gastrik si psh dispepsitë, refluksin gastro-efozageal, ulcerat peptike.

Barnat që mbrojnë mukozën janë substanca që duke rënë në kontakt me mukozën e zonës ulceroze krijojnë një cipë mbrojtëse që e ruan mukozën nga veprimi i HCL. Këto preparate përdoren në trajtimin e ulcerave gastroduodenale dhe gastritit kronik.

Enzimët digjестive

Në grupin e enzimave digjестive futen pankreatina, pankrelipaza. Enzimët përdoren si terapi zëvendësuese në rastin e deficitit të prodhimit të tyre nga aparati tretës. Përdoren në sëmundjet që shoqërohen me insuficiencën e enzimave të pankreasit (në fibrozën cistike, pankreatitin kronik, kancerin e pankreasit, sindromin e malabsorbimit, operacionet e stomakut dhe pankreasit etj).

Laksativët

Janë substanca që veprojnë duke shpejtuar zbrazjen e aparatit tretës. Sipas mekanizmit të veprimit i ndajmë në katër grupe :

1. Laksativët volumformues me përfaqësues metilcelulozën. Këto janë substanca që kur merren nga goja nuk përthithen nga mukoza e aparatit tretës por tërheqin ujë drejt zorrës dhe duke rritur volumin e përmbajtjes në zorrë nxitin peristaltikën duke favorizuar kështu zbrazjen e aparatit tretës.
2. Laksativët lubrifikues me përfaqësues vajin e parafines, vajin e vazelines të cilat duke qënë yndyrna zbutin përmbajtjen e ushqimeve në zorrë dhe lehtësojnë zbrazjen.
3. Laksativët kriporë me përfaqësues sulfatin e magneziumit, citratin e magneziumit, laktuloza etj. Këto preparate nuk thithen nga mukoza e zorrës por krijojnë një tretësirë hipertoniqe që tërheq lëngjet nga qelizat epiteliale të zorrës dhe duke rritur vëllimin e përmbajtjes së zorrës shtojnë peristaltikën.
4. Laksativët stimulues me përfaqësues bisakodil, kaskara segrada, fenoftaleina, gjethet e senës etj. Këto preparate si pasojë e veprimit irritues mbi mukozën e zorrës shkaktojnë shtimin e peristaltikës.

Indikimet :

- Për trajtimin e konstipacioneve (keshillohen trajtime për një kohë të shkurtër sepse përdorimet e gjata favorizojnë zhvillimin e crregullimeve intestinale kronike si dhe krijojnë një vartësi të lëvizshmërisë gastrointestinale ndaj tyre) ;
- Përpara ekzaminimeve radiologjike ;
- Për të shoqëruar preparatet antihelmintike ;
- Në raste helmimesh nga barna të ndryshme.

Antidiarreikët

Tek barnat antidiarreike bëjnë pjesë loperamidi, kaolina, difenoksilati, tinktura e opiumit, kodeina. Në praktikën e përditshme më i përdorshmi është loperamidi. Këto preparate përdoren për trajtimin e diarreve.

Emetikët

Janë substanca që veprojnë duke provokuar të vjellat. Sipas mekanizmit të veprimit dallojmë dy grupe :

1. Me veprim qendror direkt në qendrën e të vjellit (apomorfina) ;
2. Me veprim periferik (alkaloidet e ipekakuanës) të cilat duke ngacmuar receptorët e stomakut me mekanizëm reflektor nxitin qendrën e të vjellës

Emetikët përdoren për zbrazjen e shpejtë të stomakut në raste helmimesh aksidentale ose të qëllimshme nga substanca të marra nga goja.


Antiemetikët

Antiemetikë janë preparatet që përdoren kundër të vjellave. Preparatet më të përdorshme janë metoklopramidi, ondasetroni dhe deksametazoni por si të tillë mund të përdoren edhe antipsikotikët (proklorperazina, perfernazina, tietilperazina), kolinolitikët (skopolamina), antihistaminiket (dimenhidrinat, prometazina).

Metoklopramidi përdoret për parandalimin e të vjellave pas operacionit , në të vjellat nga kimioterapia, gastropareza, të vjellat nga migrena, sëmundja e udhetimit .

Ondansetroni është antagonist i serotoninës. Ai ka veprim më të fuqishëm antivomitiv se metoklopramidi dhe përdoret në të vjellat pas kimioterapisë apo radioterapisë.

Tema 13. Barnat me efekt tek syri dhe veshi



Konjuktiviti

Termi konjuktivitit përfshin një grup gjendjesh, të prezantuara si inflamacion i konjunktivës. Konjuktiviti është shkaku kryesor i të ashtuquajtur “ syri i kuq “. Shkaku më i shpeshtë i konjuktivitit është një infeksion bakterial/viral. Por ka edhe shkaqe të tjera si sëmundjet seksualisht të transmetueshme, alergjitë okulare etj.

Mjekimi i konjuktivitit akut :

- Eritromicinë pomade ;
- Bacitracinë- polimiksinë B pomade ;
- Gentamicinë solucion ;
- Tobramicinë solucion ;
- Ciprofloksacinë ;
- Kloramfenikol solucion.

Mjekimi i konjuktivitit kronik :

- Bacitracinë ;
- Eritromicinë ;

Mjekimi i konjuktivitit viral :

- Steroidet (në rastet e rënda)

Mjekimi i konjuktivitit alergjik :

- Steroidë ;
- Vazokonstriktorë lokalë .

Kriza glaukumatoze

Kriza glaukumatoze ka të bëjë me rritje të shpejtë të presionit intraokular, të shoqëruar me rënie të pamjes. Gjendja konsiderohet si urgjencë mjekësore. Moshë, historia familjare, miopia dhe origjina e një personi, janë faktorë, që përbëjnë rrezik të madh për zhvillimin e glaukumës.

Klinikisht kemi rënie të shpejtë të shikimit, gradualisht brenda orës, me ndjenjë dhimbje në sy, të përziera, të vjella, lotim, fotofobi. Më pas, pacienti kalon në gjendje ku dominojnë dhimbja dhe të vjellat, ndërsa shikimi është shumë i dobët.

Mjekimi :

- Hospitalizimi i pacientit ;
- Solucion Pilocarpinë, 2 pika cdo 15 minuta, për katër dhënie ;
- Solucion betablokues (timolol), dy herë në ditë ;
- Solucion steroid (prednizolon) 2 pika cdo 15 minuta për katër dhëniet e para ;
- Inhibitorë të anhidrazës karbinike (acetazolamid) ;

Uveiti akut

Është inflamacion akut i uveas antriore, irisit ose korpusit ciliar. Kjo gjendje përbën një urgjencë mjekësore. Shpesh ka fillim të shpejtë, brenda ditës me rënie të pamjes, dhimbje të syrit, ndjenjë të theksuar fotofobie.

Mjekimi :

- Barna cikloplegjike (ciklopentolat 1 %) ;
- Solucion atropinë 1 % ;
- Steroide (prednizolon) ;
- Metilprednizolon ;
- Preparate imunosupresore ;
- Preparate antiglaukumatoze.

Vertigo

Vertigo është ndjenja subjektive e lëvizjes (zakonisht rrotulluese) të mjedisit përreth ose vetvetes. Shfaqet mund të jenë centrale, periferike, nga marrja e medikamenteve, nga ankthi etj. Shpesh vertigo shoqërohet me nauze, të vjella dhe djersitje. Pjesa më e madhe e vertigove zgjat pak sekonda apo pak minuta, por vertigo mund të zgjasë për orë, ditë apo javë të tëra.

Mjekimi :

Një episod vertiginoz akut dhe i rëndë pavarësisht nga shkaku zakonisht do të qetësohet vetvetiu brenda 24-48 orësh për shkak të kompensimit të trungut cerebral. Gjatë kësaj faze akute mund të arrihet trajtimi simptomatik me qëndrim në shtrat, antiemetikë dhe antihistaminik.

Antihistaminikë :

- Prometazinë 12.5 – 25 mg oral ose IM ose rektal per 14 – 12 orë ;
- Betahistinë 4 – 16 mg për 8 orë ;

Benzodiazepina :

- Diazepam 2 – 10 mg oral ;
- Lorazepam 0.5 – 2 mg oral ;

Antiemetikë :

- Prochlorperazinë 5 – 10 mg oral ;
- Metoklopramid 10 – 20 mg oral .

Zakonisht medikamentet janë ndihmëse në vertigo që zgjat disa orë deri disa ditë, por nuk janë shumë ndihmëse në vertigo pozicionale beninje sepse kjo zgjat disa sekonda dhe më pak se një minutë.

Otiti media

Otiti media është inflamacion i veshit të mesëm, haset më tepër në moshat 6-15 muajsh dhe 5 vjec. Shfaqet në disa forma :

1. OMA (otiti media akut) është infeksion i veshit të mesëm me fillim të shpejtë të shenjave si temperaturë e lartë, dhimbje veshi, irritueshmeri dhe pamje anormale.
2. OME (otit media me efuzion/seroz) është prani e likidit në veshin e mesëm pa shenja infeksioni akut. Nëse likidi është I pranishëm mbi 4 muaj quhet OME kronik.
3. OMA rekurent kur ka 3 ose më tepër episode të vecanta OMA brënda 6 muaj ose 4 apo më tepër episode të vecanta OMA në 12 muaj.
4. OM supurativ është infeksion kronik I veshit të mesëm që con në rupturë të membranës timpanike me rrjedhje purulente.
5. OMA persistent kur OMA persiston edhe pas dhënies të të paktën 2 kurave me antibiotik oral

Mënyra më e mirë e trajtimit të OMA :

- Këshillim dhe informim i prindërve ;
- Dhënia e analgjezikëve (paracetamol, ibuprofen);
- Dhënia e antibiotikëve (amoksisilinë, penicilinë, cefalosporinë, azitromicinë, klaritromicinë, cefriakson).

Tema 14. Kimioterapia



Antibakterialët

Në historinë e zbulimit të preparateve antimikrobike, për herë të parë në fillim të shek 20 Paul Ehrlich gjatë përshkrimit të substancave me efekt kundër parazitëve përdori termin kimioterapeutik. Me këtë ai kuptonte kimikatet sintetike me veprim kundër mikrobeve. Disa nga kimikatet sintetike kanë efekte citostatike (antikanceroze). Termi antibiotik u përdor fillimisht kur u vu në përdorim penicilina sepse ideja e zbulimit të saj u mbështet në fenomenin e antibiozës. Në përkufizimin e sotëm termat antibiotik dhe kimioterapeutik mund të zëvendësojnë njëri-tjetrin sepse pavarësisht nga origjina e tyre, në përmbajtje, të dy termat përdoren për të treguar preparatet me veprim kundër mikrobeve. Preparatet antimikrobike sipas spektrit të veprimit klasifikohen :

1. Antibakterialët ;
2. Antimykotikët ;

3. Antiviralët ;
4. Antihelmintikët ;
5. Antiparazitarët .

Spektri antimikrobik

Me spektër antimikrobik kuptojmë tërësinë e mikrobeve të ndjeshme ndaj veprimit të një antibiotiku të dhënë. Në bazë të spektrit të veprimit dallojmë antibiotik me spektër të ngushtë veprimi (penicilinat) dhe antibiotik me spektër të gjërë veprimi (tetraciklinat, kloramfenikoli, sulfamidet, kinolonet etj).

Ndjeshmeria ndaj antibiotikëve

Disa antibiotikë veprojnë duke i shkatërruar mikrobet, pra ato tregojnë efekt baktericid. Antibiotikë të tjerë veprojnë duke penguar vetëm zhvillimin e mikrobit. Pra tregojnë efekt bakteriostatik.

Antibiotikët betalaktamikë

Përfaqësuesi i parë i këtij grupi është benzilpenicilina (penicilina G). Duke u nisur nga struktura betalaktamike e kësaj peniciline janë përftuar me rrugë sintetike dhe gjysëm sintetike një numër i madh antibiotikësh që në vartësi të spektrit të veprimit të tyre i klasifikojmë si më poshtë :

1. Penicilinat
 - Penicilinat me spektër të ngushtë veprimi (specter G) ku futen benzilpenicilina, prokainpenicilina, bipenicelina, benzatinpenicillina etj;
 - Penicilinat antistafilokoksike (spektër M) ku bëjnë pjesë meticillina, oxacillina etj;
 - Penicilinat me spektër të gjërë (spektër A) si ampicillina, amoxicillina, karbenicillina, piperacilina etj.
2. Cefalosporinat
 - Cefalosporinat e gjeneratës së parë si cefalotina, cefaloxina etj;
 - Cefalosporinat e gjeneratës së dytë si cefamandoli, cefuroxima etj;
 - Cefalosporinat e gjeneratës së tretë si cefotaxima, ceftazidima etj.

Të gjithë antibiotikët betalaktamikë duke penguar formimin e murit qelizor të mikrobit tregojnë veprim baktericid ndaj tyre.

Indikimet :

Penicilinat dhe cefalosporinat përdoren në infeksionet nga mikrobet e ndjeshme ndaj tyre. Zgjedhja brënda grupit të penicilinave dhe cefalosporinave do të bëhet në varësi të spektrit të secilit preparat dhe farmakokinetikës së tyre. Psh në infeksionet e rënda nga grupi i kokëve sidomos streptokokët preferohet penicilina G sepse është e vetmja penicilinë me specter të ngushtë që mund të injektohet në venë. Në infeksionet e zakonshme nga streptokokët (bronkopneumoni, tonsilitet, otitet etj) përdoret prokainpenicilina ose bipenicilina. Në infeksionet stafilokoksike preferohen penicilinat e spektrit M ose cefalosporinat e gjeneracionit të parë dhe të dytë. Në infeksionet nga bacilet gram negative si dhe në infeksionet meningeale preferohen

penicilinat e spektrit A dhe cefalosporinat e gjeneratës së tretë të cilat kanë mundësi të kalojnë me lehtësi në lëngun trunoshpinor.

Antibiotikët aminoizidikë

Antibiotikët aminoizidikë përfaqësohen nga streptomocina, kanamicina, neomicina, tobramicina, netilmicina etj. Janë antibiotikë me spektër të gjërë veprimi, vecanërisht efektivë ndaj bacileve gram negative përfshirë edhe mykobakteriumin e tuberkulozit. Këto preparate tregojnë efekt baktericid ndaj mikrobeve.

Indikimet :

Në përgjithësi janë molekula toksike dhe për këtë arsye disa prej tyre si psh neomicina përdoren vetëm lokalisht në lëkurë, mukoza, në formë pomade si dhe për dezinfektimin e aparatit tretës para ndërhyrjeve kirurgjikale në zorrë ose gjatë komës hepatike. Preparatet e tjera mund të përdoren në trajtimin e infeksioneve të rënda (endokarditet, gjëndjet septike, meningjitet) zakonisht të shoqëruara me penicilinat dhe cefalosporinat. Ato mund të përdoren edhe në infeksionet e aparatit urinar apo trajtimin e pneumonive të shkaktuar nga mikrobet gram negative.

Kinolonet

Në kinolonet bëjnë pjesë acidi nalidiksik (negrami) si dhe derivatet e fluoruara si psh ciprofloxacina, pefloxacina, norfloxacina etj. Janë antibiotik me veprim baktericid. Kinolonet e fluoruara kanë veprim më të fuqishëm dhe spekter më të gjërë veprimi. Ato veprojnë shumë mire ndaj stafilokokëve, klamidieve, mykoplazmës dhe shkaktarir të brucelozës.

Indikimet :

Negrami përdoret në infeksionet e vijave të poshtëme urinare. Norfloksacina përdoret në infeksionet e prostatës dhe infeksionet e tjera të indit renal ndësa ciprofloksacina meqënëse depërton më mire në indet e ndryshme përdoret edhe në infeksionet e tjera sistematike rezistente ndja preparateve si psh në infeksionet respiratore, osteomielitet, infeksionet gastrointestinale etj. Fluorokinolonet mund të jenë pjesë përbërëse e politerapisë antituberkulare.

Tetraciklinat

Tetraciklinat së bashku me kloramfenikolin janë antibiotikët që kanë spektrin më të gjërë të veprimit. Në këtë grup futen tetraciklinat klasike si psh tetraciklina, klortetraciklina, oksitetraciklina, po ashtu edhe ato më te rejt si psh. Doksiciklina, minociklina etj. Tetraciklinat tregojnë veprim më të mire sidomos ndaj rikecieve, brucelozës, klamidiet, mykoplazmës etj. Ato kanë veprim bakteriostatik.

Indikimet :

Tetraciklinat duke qënëse janë përdorur gjërësisht, ndaj tyre shumë microbe janë bërë rezistente. Për këtë arsye si dhe fakti që ka shumë antibiotikë të tjerë më pak toksikë kanë bërë që përdorimi i tyre të vijë duke u ulur. Sot ato përdoren kryesisht në infeksionet respiratore e urinare të

shkaktuara nga mykoplazma, klamydiet në trajtimin e rikeciozave, psitakozës, infeksionet që transmetohen me rrugë seksuale, kolerë si dhe në infeksionet e ndryshme kur pacientet janë alergjikë ose rezistentë ndaj penicilinave.

Kloramfenikoli

Kloramfenikoli është antibiotik me spektër shumë të gjërë veprimi. Ai vepron vecanërisht mire ndaj grupit të enterobakterieve. Në përgjithësi tregon efekt bakteriostatik ndaj mikrobeve me përjashtim të shkaktarit të tifos bakteriale ndaj të cilit tregon veprim baktericid.

Indikimet :

Për shkak të toksicitetit të lartë kloramfenikoli ka përdorime të kufizuara. Ajo përdoret në trajtimin e tifos abdominale, meningjiteve, rikeciozave, infeksionet anaerobike si dhe në rastet kur terapia me antibiotikët e tjerë ka dështuar.

Makrolidët dhe antibiotikët e ngjashëm me to

Në antibiotikët makrolidë bëjnë pjesë ertromicina, spiramicina, azitromicina, troleandomicina etj ndërsa në antibiotikët e ngjashëm me to futet klindamicina etj. Janë antibiotikë me spektër të gjërë veprimi. Ata tregojnë në përgjithësi efekt bakteriostatik ndaj mikrobeve. Karakteristike e tyre është se veprojnë edhe ndaj mikrobeve që kanë fituar rezistencë ndaj penicilinave.

Makrolidët përdoren në rastet kur kemi infeksione rezistente ndaj penicilinave, si dhe në pacientët alergjikë ndaj penicilinave. Preferohen në infeksionet respiratore dhe urinare të shkaktuara nga klamydia dhe mykoplazma, në mjekimin e rikeciozave etj. Spiramicina preferohet në infeksionet e gojës sepse eliminohet me anë të gjëndrave të pështymës.

Klindamicina ka spekter të ngjashëm me makrolidët. Ajo vepron shumë mirë ndaj stafilokokëve, pneumokokëve, streptokokëve prandaj përdoret në rastet e infeksioneve rezistente ndaj penicilinave ose në njerëzit alergjik ndaj penicilinave.

Polipeptidikët

Polimixina është antibiotik me spektër të gjërë veprimi. Ajo tregon veprim baktericid sidomos ndaj bacileve gram negative. Përdoret rrallë për shkak të toksicitetit të lartë si dhe të rishpërndarjes jo të mire në inde. Zakonisht përdoret lokalisht në infeksionet e lëkurës dhe aparatit tretës.

Glukopeptidet

Vankomicina dhe teikoplanina janë antibiotikë me veprim baktericid që veprojnë kryesisht ndaj grupit të kokëve, sidomos stafilokokëve. Përdoren në infeksionet stafilokoksike rezistente ndaj barnave të tjera.

Sulfamidet

Sulfamidet janë substancat e para të përdorura për trajtimin e sëmundjeve infektive në tërësinë e organizmit. Zbulimi i penicilinave dhe antibiotikëve të tjerë si dhe rritja gjithnjë e më shumë e numrit të mikrobeve rezistente ndaj sulfamideve e ka kufizuar gjithnjë e më shumë përdorimin e tyre. Megjithatë ato përdoren me sukses në trajtimin e koliteve ulceroze. Sulfamidet tregojnë veprim bakteriostatik ndaj mikrobeve.

Baktrima

Baktrima është kombinimi i sulfametoksazolit me trimetoprimën. Ky kombinim rrit deri 100 herë veprimin antimikrobik duke treguar veprim baktericid ndaj tyre.

Indimimet :

- Infeksionet e pakomplikuara të traktit të posht poshtëm urinar ;
- Infeksionet respiratore si bronkiet, në otitet, sinuzitet ;
- Infeksionet e aparatit tretës ;
- Në brucelozë, nokardiozë etj.

Antituberkularët

Tuberkulozi është sëmundje e shkaktuar nga mykobakteriumi I TBC. Është një infektion i vështirë për tu trajtuar për shkak të shumëllojshmërisë së shtameve që ka, ndjeshmërisë të ndryshme të tyre ndaj preparateve antituberkulare si dhe të shumëllojshmërisë të lokalizimeve të këtij infeksioni. Në preparatet antituberkulare bëjnë pjesë izoniazidi, rifampicina, etambutoli, etionamidi, pirazinamidi, streptomocina etj. Antituberkularët përdoren për mjekimin e tuberkulozit si dhe për profilaksinë e tyre.

Antimykotikët

Infeksionet mykotike janë mjaft të shpeshta në praktikën mjekësore. Infeksionet mykotike (nga funget) sipas lokalizimit janë dy llojesh :

1. Infeksione mykotike sipërfaqësore ;
2. Infeksione mykotike të thella.

Infeksionet sipërfaqësore lokalizohen në lëkurë, thonj, aparatit tretës ndërsa infeksionet e thella zhvillohen në brëndësi të organizmit, në organe të ndryshme si psh. Mushkëri, meningjet, endokard etj.

Antimykotikët ose ndryshe antifungalet janë : nistatina, amfotericina, fluocitozina, mikonazoli, ketokonazoli, flukonazoli, grizeofulvina etj. Këto preparate veprojnë kundër mykrave të ndryshme duke treguar në vartësi nga doza dhe lloji i preparatit efekt fungistatik ose fungicide. Ato përdoren për trajtimin e infeksioneve mykotike në vartësi nga ndjeshmëria që tregojnë këto mykra ndaj preparateve të ndryshme. Përdorimi i zgjatur favorizon zhvillimin e rezistencës ndaj tyre. Ketokonazoli zotëron edhe efekte frenuese ndaj korteksit të gjëndrës suprarenale prandaj

përdoret me sukses në mjekimin e sëmundjes Cushing, për mjekimin e pubertetit të parakohshëm dhe hirsutizmit tek femrat dhe si terapi ndihmëse në kancerin e prostatës.

Antiviralët

Viruset janë mikroorganizma që nuk kanë metabolizëm të vetin por shumohen duke shfrytëzuar qelizën e infektuar nga ata. Prandaj, për mjekimin e infeksioneve virale, me qëllim që të pengohet shumëzimi i tyre, në qelizën e infektuar, duhen frenuar ato stadi metabolike që shërbejnë për shumëzimin e viruseve. Megjithatë jo gjithmonë kemi mundësi të luftojmë kundër një infeksioni viral. Në preparatet antivirale bëjnë pjesë : aciclovir, valacikloviri, amantadina, zidovudina, lamivudina, vidarabina, sakuinaviri, ritonaviri, interferoni etj.

Preparatet antivirale përgjithësisht frenojnë replikimin ose transkriptimin e AND dhe ARN virale duke cuar në ngordhjen e viruseve kurse interferoni favorizon sintezën e proteinave antivirale. Kundër virusit të HIV-it veprojnë zidovudine, lamivudine, sakuinoviri, ritonavir etj. Antiviralet nuk veprojnë ndaj viruseve që janë në gjendje qetësie dhe nuk sigurojnë mbrojtje afatgjatë sic bëjnë vaksinat.

Antiviralët përdoren në një sërë sëmundjesh virale si : gripi, encefalitet virale, ethe hemoragjike, gastroenteritet virale, mjekimin dhe profilaksinë e HIV-it, infeksionet e lëkurës dhe të mukozave të shkaktuara nga virusi Herpes simplex, Herpes zoster etj. Barnat që veprojnë kundër viruseve përdoren si për mjekimin edhe për profilaksinë e këtyre infeksioneve.

Antihelmintikët janë barna që veprojnë kundër parazitëve të ndryshëm në organizmin e njeriut, të vendosura në aparatit tretës apo në inde dhe organe të ndryshme. Ata kanë një përdorim të gjërë në praktikën mjekësore për shkak të përhapjes së madhe të helmintiazave (krimbave). Në helmintet bëjnë pjesë : ascaris lumbricoides, enterobius vermicularis, ancylostoma duodenalis, teania solium, hymmenolepis nana, fasciola hepatica etj. Zakonisht barnat antihelmintike veprojnë duke paralizuar ose duke e nxitur muskulaturën e krimbave dhe në këtë mënyrë i shkëpusi ato nga mukozat e zorrëve ku janë fiksuar.

Indikimet :

Antihelmintikët përdoren kundër helmintiazave. Nëse identifikohet prania e parazitëve në fece, mjekimi duhet filluar menjëherë në vartësi të llojit të krimbit. Që mjekimi të jetë sa më i efektshëm duhet që i sëmuri të respektojë dhe disa rregulla si më poshtë:

- Këshillohet që 2-3 ditë para mjekimit i sëmuri të përdorë ushqime të lehta që të thithen mire ;
- Si rregull substancat antihelminike jepen në mëngjes esëll ose pas 1-2 orësh jepet një pastrues kripor për të nxjerrë parazitin jashtë organizmin ;
- Edhe gjatë ditëve të mjekimit i sëmuri këshillohet të marrë ushqime të pasura me karbohidrate dhe të varfra me yndyrna ;
- I sëmuri duhet të mbajë higjienë vetiake.

Amebicidet përdoren për trajtimin e amebiazave, sëmundje të shkaktuara nga entameba histolitica. Amebiazat intestinale janë më të lehta për tu mjekuar. Në trajtimin e amebiazave

intestinale përdoret metronidazole, tinidazoli, paromomicina, iodoquinoli ndërsa në amebiazat hepatike përdoret klorokina, tinidazoli etj.

Antikancerozët

Antikancerozët ose ndryshe citostatikët janë preparate që përdoren për mjekimin e sëmundjeve malinje. Këto preparate nuk shërojnë komplet të sëmurin por në shumicën e rasteve ngadalësojnë shkallën e ecurisë së sëmundjes dhe afatin e shfaqjes të metastazave.

Në antikancerozët bëjnë pjesë agjentët alkilantë, antimetabolitët, antibiotikët antitumoralë, inhibitorët mitotikë, hormonet etj.

Kanceri është një sëmundje që karakterizohet me shumëzim të pakontrolluar të qelizave dhe që shoqërohet me metastaza dhe invadim të indeve përreth. Preparatet antikanceroze tregojnë efekt edhe mbi qelizat e tjera të organizmit që normalisht rigjenerohen më shpejt.

Antikancerozët përdoren vetëm ose të kombinuar midis tyre. Megjithatë efektiviteti i tyre jo gjithmonë është i garantuar.

Tema 15. Alergjia medikamentoze dhe efektet e padëshiruara të barnave

Efektet anësore të barnave

Efektet anësore të barnave, janë efektet e dëmshme të shkaktuara nga përdorimi i dozave terapeutike trdorimi i dozave terapeutike të barnave. Sipas mekanizmit i klasifikojme : efekte toksike, imunoalergjike, idiosinkrazike, toleranca, vartësia, efektet lokale ose efekte të ekzagjuruara farmakologjike.

Efektet toksike janë të rralla dhe mund të manifestohen me dëmtime të melcisë (nekroza hepatike e shkaktuar nga përdorimi i zgjatur i paracetamolit), dëmtime në veshka (nefriti intersticial i shkaktuar nga fenacetina), dëmtimi i çiftit të tetë të nervave kranialë (streptomocina, kanamicina), efekte teratogjene kur përdoren nga gruaja shtatëzënë (malformacionet e shkaktuara nga citostatikët), efekte kancerogjene dhe efekte mutagjene ndaj ADN-së(agjentët alkilantë).

Reaksionet alergjike janë ndjeshmëria e rritur e fituar e organizmit nga marrja e përsëritur e barnave. Në bazë të tyre është krijimi i kompleksit antigjen-antitrop i cili bëhet shkak për clirimin e hormoneve dhe mediatorëve lokalë (histaminës, PG, leukotrieneve etj) të cilat krijojnë shqetësime tek pacienti. Klinikisht reaksionet alergjike manifestohen me urtikarie, prurit, rinit, astmë, anemi hemolitike, dëmtime të organeve të ndryshme deri në format më të rënda si shoku anafilaktik.

Indiosinkrazia është intoleranca e lindur e organizmit ndaj një bari të caktuar. Përgjigjia e organizmit është e ndryshme nga ajo e zakonshme. Shembull tipik është prokainamidi të cilin afro 20 % e njerëzve nuk e tolerojnë dot.

Ambientimi është ulja e ngadalshme e reaktivitetit të organizmit ndaj marrjes së përsëritur të barnave. Për të marrë efektin e dëshiruar në këtë rast duhet të rrisim dozën e preparatit.

Takifilaksia është ulja e shpejtë (për disa orë) e reaktivitetit të organizmit ndaj një bari kur intervalet e përsëritjes së tij janë të shkurtra. Shembull tipik është efedrina.

Vartësia (dependenca, apasionimi) është formë e vecantë e ambjentimit ndaj një bari kur ai merret në mënyrë të përsëritur (morfina). Ajo karakterizohet nga vartësia psikike (sepse pacienti nuk I reziston dot mungesës së efektit euforik të barit) dhe vartësia fizike (domosdoshmëria që ndjen për të marrë këtë lëndë që është bërë e domosdoshme për mbajtjen e homeostazës së organizmit). Nëse nuk e merr këtë lëndë atëhere pas 12 orësh shfaqen një sërë simptomash nga të gjitha organet. Tërësia e këtyre shenjave që shfaq I sëmuri që nuk e merr substancën ndaj të cilës është apasionuar quhet abstinencia.

Efektet locale janë tërësia e efekteve që tregon bari në vendin e aplikimit. Lokalisht një pjesë e barnave japin irritime të indeve, gjë që bëhet shkak që kur ato merren nga goja provokojne pështjellime, të vjella, diarre ndërsa kur I merr me injeksione mund të japin tromboflebite dhe tromboembolira (prandaj në këtë rast duhet ndryshuar vena herë pas here) ose deri në nekrozë të indeve kur agia del nga ena e gjakut dhe bari zbrazet në indet përreth enës.

Efektet anësore

- Gjatë përdorimit të disa medikamenteve mund të shfaqen një sërë efektsh anësore. Më të zakonshmet janë : pështjellime, të vjella, diarre, konstipacion, marrje mendsh, përgjumësi, tharje goje, skuqje të lëkurës etj. Disa prej tyre kalojnë me kohë ose me rregullimin e dozës nga mjeku. Disa here ato janë të tolerueshme por në raste të tjera janë mjaft serioze.
- Në përgjithësi këshillohet që për efektet anësore të kontaktohet me mjekun sa më parë të jetë e mundur.
- Në rast se pacienti është alergjik ndaj ndonjë bari duhet që para çdo mjekimi të informojë për këtë personelin mjekësor.

Këshilla për familjarët

- Asnjëherë një medikament i marrë për një person të familjes nuk duhet përdorur për një person tjetër pa këshillën e mjekut.
- Pacienti duhet të informohet për të gjitha procedurat e realizuara.
- Një instruksion i mirë i pacientit dhe familjarëve ka mundësi të evitojë një sërë efektsh të padëshiruara.

Tema 16. Bimët mjekësore dhe barnat popullore



Bimët janë elementi kryesorë i mjekësisë popullore. Ato kanë ecur paralelisht me mjekësinë teknologjike por për disa bimët janë kurimi më i efektshëm. Ja disa dobi nga bimët mjekësore:

1. **ZEMRA/MURRIZI.** Murrizi, është shumë i njohur në vendin tonë. Ajo që duhet theksuar, lidhet ngushtë me faktin se për Mjekësinë Popullore, murrizi nuk është vetëm një shkurre, që shërben si ushqim për kafshët, por edhe një bimë e pasur me substanca, të cilat ndihmojnë në parandalimin dhe lehtësimin e shumë sëmundjeve. Kryesisht ndihmon të gjithë ata që kanë probleme me zemrën, pasi forcon muskujt e këtij organi dhe i siguron ritëm normal. Kjo bimë është e pasur me lëndë vepruese. Përmban substanca flavonike, adeninë, adenosinë, guaninë, aminopurinë, krategalaktone dhe derivate tritepenilë. Çaji ndihmon edhe kur të sëmurët ndiejnë dhimbje të zemrës. Në këto raste këshillohet që, përveç pirjes së çajit, i sëmuri duhet të drejtohet patjetër për vizitë te mjeku përkatës. Rezultate të shkëlqyera jep ky çaj edhe për të normalizuar goditjet e forta, që pëson ky organ.
2. **MIGRENA/BAR-BLETA.** Bar bleta është një bimë mjaft e njohur në mjekësinë popullore. Prej kohësh çaji i përfutur nga kjo bimë ka ndihmuar në parandalimin dhe lehtësimin e shumë sëmundjeve. Një rol të rëndësishëm lulebleta luan në qetësimin e dhimbjeve të migrenës. Çaji rekomandohet kryesisht kur ajo karakterizohet nga dhimbje të forta të kokës dhe sidomos në gjysmën e saj. Në këtë rast këshillohet të pihet menjëherë një gotë çaj barblete. Shumë shpejt të sëmurët do shohin rezultatet e shkëlqyera të bimës. Ky çaj ndihmon edhe në parandalimin dhe qetësimin e sëmundjeve të shfaqura në mëlçi.
3. **RËNIA E FLOKËVE/HITHRA.** Në mjekësinë popullore hithra njihet si mbretëresha e bimëve mjekësore, për shkak të efekteve të saj pozitive në shërimin e disa sëmundjeve. Përdorimi i kësaj bime gjatë periudhës së pranverës ndihmon në pastrimin e gjakut dhe të të sëmurët me anemi. Në kozmetikë ndihmon kundër rënies së flokut dhe zbokthit. Personat që kanë probleme me zbokthin u rekomandohet larja e kokës me lëngun që përftohet nga zierja e hithrës. Është mirë që larja të kryhet dy herë në javë dhe të vazhdojë deri në eliminimin përfundimtar të zbokthit. Larja e kokës me ujin e hithrës këshillohet edhe për ata që kanë probleme me rritjen e ngadaltë të flokut.

4. SPINAQI/ REUMATIZMA. Bima e sinapit para 300 vjetësh përdorej nga kinezët si erëz për t'i dhënë shije ushqimeve. Më pas një mjek grek, pas eksperimenteve të kryera me të, zbuloi se sinapi mund të përdorej për lehtësimin e dhimbjeve të reumatizmit. Në sajë të esencave, që lirohen nga farat e sinapit, duke i shtypur dhe mbajtur në ujë me temperaturë 25 deri 35 gradë, lëngu ka veti të irritojë dhe të skuqë lëkurën. Për efektin që jep në lëkurë, sinapi në formë banjash përdoret për të aktivizuar qarkullimin e gjakut. Në këtë mënyrë pakëson ose mund t'i largojë plotësisht dhimbjet reumatizmale. Kurimi i sëmundjes mund të bëhet në dy mënyra. Së pari, farat e sinapit pasi bluhën përftohet një pluhur, i cili përdoret për të krijuar një masë në formë brumi dhe vendoset në vendin ku ndihen dhimbjet.
5. HIPERTENSIONI/LIMONI. Një mënyrë mjaft e suksesshme për uljen e tensionit të lartë të gjakut, është lëngu i limonit. Mjekët popullorë rekomandojnë lëngun e përftuar nga shtrydhja e të paktën 4 kokrrave në ditë. Lëngu mund të pihet ashtu siç është ose i ëmbëlsuar. Kura me limon këshillohet të zgjasë për 2 muaj. Sëmundja e hipertensionit, është pasojë e çrregullimeve të funksioneve të aparateve nervore qendrore, që marrin pjesë në rregullimin e presionit të gjakut. Por ajo mund të shfaqet edhe me rritjen e moshës si dhe prej sëmundjeve të veshkave. Shenjat e sëmundjes shfaqen gradualisht. Presioni arterial, në fazat fillestare, lëkundet me ngritje e zbritje dhe më vonë stabilizohet me shifra të ngritura.

Për sëmundje të shumta në trupin e njeriut si p.sh., obeziteti, diabeti, sëmundjet e zemrës, forma të ndryshme tumorale, etj; shpesh si shkak kryesor kanë një regjim ushqimor dhe një ushqim të papërshtatshëm. Por jo vetëm kaq. Mjaft prej tyre mund të arrijnë të parandaloheshin falë një ushqyerje të shëndetshme dhe të ekuilibruar. Ndërkohë, shkenca ka arritur, falë studimeve të ndryshme, që të tregojë se mjekimi nëpërmjet ushqyerjes së përshtatshme (terapia mjekësore popullore) përmirëson cilësinë e jetës dhe kursen shpenzime për kujdesin mjekësor. Por çfarë është një ushqyerje e përshtatshme dhe e ekuilibruar?

Mund të merrni përgjigje për shumë nga pyetjet që çdokujt mund t'i linden në jetën e përditshme, siç janë roli dhe funksioni i yndyrnave, proteinave, vitaminave, çfarë është një dietë e shëndetshme, dhe për shumë elemente të tjera të rëndësishme që përbëjnë atë që quhet një ushqyerje e shëndetshme. Dieta është mënyra e vetme për t'i lënë të pushojnë organet jetësore dhe për t'i ndihmuar ato të funksionojnë sa më mirë, duke shmangur problemet e ndryshme shëndetësore.

Është e nevojshme të mësohet një teknikë sa më e përshtatshme për një dietë efikase dhe pa rreziqe, si edhe "sekrete" të tjera për një shëndet të mirë. Cilat janë ushqimet që kurojnë aneminë, frutat e perimet e dobishme për organizmin. Ndërsa më poshtë, radhiten këshilla dhe receta me bimë e ushqime, të cilat janë të njohura për efektet e tyre kundër të gjitha sëmundjeve më të shpeshta që rrezikojnë organizmin e njeriut. Këto e shumë të tjera në një suplement prej pesë faqesh, një strategji e vërtetë për një jetë të shëndetshme.

Cilat bimë kurojnë aneminë, sëmundjet e zemrës. Një sërë recetash të mbështetura në

mjekësinë moderne, por aq dhe në atë popullore, për të kuruar sëmundje të ndryshme që shfaqen në organizmin tonë. Këshillat më të fundit që japin mjekët për të shmangur sëmundjet e zemrës, stomakut, aparatit tretës, gripit. Si të luftoni kancerin, diabetin e shumë shqetësime të tjera me fruta dhe perime. Si të shmangni sëmundjet e ndryshme, cila është strategjia e duhur për një jetë të shëndetshme. Cilat janë recetat më të fundit të rekomanduara nga mjekët për të qenë të shëndetshëm. Gjithçka në numrin e sotëm në një suplement prej pesë faqesh, një strategji e vërtetë për një jetë të shëndetshme. Do të gjeni këshilla dhe receta për të luftuar çdo sëmundje që ju shqetëson.

Ilaçet Popullore kundër anemisë

Të sëmurët anemikë duhet të konsumojnë ushqime të pasura me hekur, si: mish, peshk, shpretkë, vezë, perime, fruta etj. Këtyre të sëmurëve u këshillohet përdorimi i frutave të freskëta, që përmbajnë vitamine C, e cila ndihmon në absorbimin ose marrjen e hekurit. Nëse pinë kafe, çaj, kakao apo edhe lëngje të tjera, që përmbajnë kafeinë, duhet t'i marrin dy orë para ose pas ushqimit, sepse vështirësojnë absorbimin e hekurit. Në numrin e këtij suplementi, janë për zgjedhur disa nga ushqimet bazë të cilat luftojnë sëmundjen e anemisë dhe ndihmojnë të gjithë pacientët kronikë të kësaj sëmundje ta ndjejnë sa më pak atë. Gjithçka përgatitet dhe konsumohet në kushtet e shtëpisë, pa shpenzime të mëdha financiare.

HURMA

Hurma duket të jetë edhe një nga frutat bazë, që ndihmon në eliminimin e sëmundjes. Për kurimin e anemisë në mjekësinë popullore përdoren pothuajse të gjitha pjesët e bimës, frutat, gjethet, degët, rrënjët etj. Në vendet arabe është ushqim kryesor, i cili shuan urinë për shkak të përbërjes së celulozës. Hurmat kanë gjetur përdorim të mirë kundër anemisë. Edhe në vendin tonë, mjekët popullorë i kanë kthyer të gjitha kërkimet për sëmundjen e anemisë tek hurmat. Tezë kjo e cila hedh poshtë faktin e hurmat bëjnë mirë vetëm për gjëndrat tiroide. Pasi ato janë shumë të domosdoshme të konsumohen nga të gjithë ata që kanë probleme me gjakun e tyre, kryesisht mangësira si në rastin e anemikëve.

KAROTA

Karota është e pazëvendësueshme për shëndetin e njeriut. Lëngu ditor i karotës në sasi prej 50-150 gram është ilaç efikas të sëmurët, që vuajnë nga anemia. Karota në periudhë rekord e rregullon pastrimin e gjakut. Këshillohet që të gjithë ata persona që vuajnë nga anemia, të konsumojnë minimalisht 2 karota që qëruara çdo ditë, ndërkohë që në ushqimet e tyre nuk duhet të mungojë asnjëherë karotat. Vetëm përdorimi i përditshëm i karotave sjell eliminimin e problemeve me gjakun dhe ul riskun për sëmundje të tjera.

RREPA E KUQE

Nisur edhe nga vetë ngjyra kuptohet që rrepa e kuqe është ushqimi bazë për anemikët. Këtyre të sëmurëve u këshillohet pirja çdo ditë e 150 ml lëng të rrepës së kuqe, para buke, apo të

konsumohet sa më shpesh domatja. Nga ana tjetër këta pacientë kronikë, të çfarëdo grupmoshe që të jenë, duhet të marrin çdo ditë 10 - 15 fruta të mandarinës për një kohë prej 20 - 25 ditë. Injektimi i vitaminave, lëngjeve dhe sasive të gjakut nëpërmjet frutave dhe perimeve, sipas Mjekësisë Popullore duket të jetë edhe rroga më e mirë për rritjen e nivelit të gjakut në organizëm dhe mbi të gjitha normalizimin e sistemit organik.

GJETHE HITHRE

Një kurë e efektshme për të sëmundjen e gjakut është edhe ajo e përgatitur nga 250 gramë gjethe hithre, 10 gramë uthull dhe 10 gramë gjethe delli. Të gjitha këto vendosen në 1 litër ujë të ftohtë, ku qëndrojnë 12 orë. Pastaj zihen për 10 minuta, ëmbëlsohen sipas dëshirës me mjaltë dhe pastaj sërish mbyllen dhe qëndrojnë të mbyllura për 20 minuta. Kullohen dhe pihen gjatë tërë ë ditës me lugën e kafesë. Kjo duhet të përsëritet disa herë në muaj dhe ndihmon në qarkullimin normal të gjakut si dhe rritjen e sasisë së tij në organizëm. Është një nga bazat kryesorë të Mjekësisë Popullore.

LULESHTRYDHJA

Është bimë shumëvjeçare me shije të hidhur në të ëmbël. Në fitoterapi përdoren gjethet, rrënja dhe lulet. Gjethet e reja të kësaj bime janë mjaft të pasura me vitaminë C, me kripën natyrore, e cila bën pastrimin e gjakut. Në shumë vende përdoret si sallatë, sidomos për ata që vuajnë nga anemia. Luleshtrydhja përmban glikozidet e hidhura, insulinën, taninet, vitaminën B, C dhe provitaminën A, shumë minerale, ka përqindje të lartë të kripërave të kaliumit, sidomos në gjethe, karotenoide, proteinë, pektinën, holinën etj. Në rast se konsumatorët e kanë të vështirë në periudha të caktuara që të gjejnë luleshtrydhe në treg, atyre u këshillohet edhe përdorimi i lëngjeve të frutave që me luleshtrydhe por që nuk përmbajnë gaz.

FIKU

Është një frut, që përmban shumë karbohidrate, albuminë, yndyrë. Përdoret i freskët, i tharë dhe i përpunuar në produkte të ndryshme. Rekomandohet të përdoret nga personat e dobësuar, nga anemikët dhe nga ata që ndiejnë shumë të ftohtë, pasi i japin organizmit forcë dhe nxehtësi. Një tjetër mënyrë për kurimin e të sëmurëve me anemi është edhe pirja e tri lugëve kafeje në ditë nga masa e përfutuar nga shalqiri, karafil, mastiku dhe sheqeri. Tre kokrra shalqiri mbushen me 50 gram karafil dhe 100 gram mastikë. Pasi piqen u hidhet sheqer. E gjithë masa e krijuar zihet derisa të mpikset mirë dhe pihet çdo ditë.

FARAT E ZEZA

Fara e Zezë përmban vaj acidik të pangopur, vaj me eter, vitamina dhe një sërë substancash të tjera të domosdoshme për organizmin. Tashmë është vërtetuar se vaji acidik i pangopur që përmban fara e zezë ndikon pozitivisht mbi metabolizmin e trupit, rrit imunitetin dhe ndalon alergjinë. Por farat e zeza u bëjnë mirë edhe anemike. Kjo pasi fara përmban përafërsisht 38 për qind karbohidrate, 35 për qind vajra të ndryshëm, 21 për qind albumin dhe pjesa tjetër

përbëhet prej më shumë se njëqind substanca të ndryshme. Për t'u përmendur janë: vajrat acidike të pangopura, acidi Linolein, acidi alfa-Linolein, vajrat me eter (nigellon, alfa-pinen etj.)

Bimët mjekësore që përdoren për mjekim

Aloa Vera

Për këtë bimë janë gjetur shkrime të ndryshme edhe nëpër papiruse, për të cilën thuhet se është bimë shumë e dobishme dhe nga ajo janë prodhuar tableta të vogla kundër infeksioneve të ndryshme.

Kopra

Foshnjave të posalindura iu jepet në formë çaji, për pengimin e dhembjeve dhe shtangimeve të cilat e përcjellin foshnjën në muajt e parë të lindjes. Me sukses përdoret edhe kundër kollit.

Trumëza

Është ekaspektorans i mirë dhe spazmolitik i lehtë. Ka edhe veprim bakteriologjik. Përdoret si bar për shërimin e organeve të tretjes, si edhe ndodhet si përbërës i shumë çajrave tjera.

Kamomili

Përdoret kundër dhembjeve dhe shtrëngimeve, inflamacioneve të lëkurës dhe mukozës së gojës, fytit, hundës, syve, po ashtu për rregullimin e tretjes së ushqimit, pastrimin e rrugëve urinare nga jashtë dhe brenda, kundër hemorroideve.

Mendra

Përdoret si spazmolitik (kundër ngërçeve dhe shtangimeve në lukth e organe tjera), pastaj për qetësimin e shtangieve të muskujve sidomos në organet e tretjes etj.

Lëngu i Kulfimës

Bima e kulfimës ose lulevathit është një prej bimëve më të njohura, që ndihmojnë në qarkullimin sa më të mirë të gjakut, dhe ndihmon në funksionimin e mirë të zemrës. Në rrahjet e shpejta të saj çaji ka dhënë rezultate shumë të mira. Mjekët këshillojnë pirjen e dy gotave çaji në ditë.

Kakaoja mbron nga sëmundjet e zemrës

Kakaoja mbron nga sëmundjet kardiovaskulare, stimulon neuronet, kuron gjendjen

shpirtërore. Ajo ka të gjitha vetitë e çokollatës. Stimuluese, antidepresive, për çdo nevojë afrodisiake. Për disa persona nuk ka shumë ndryshime nga një drogë. Kakaolja, mes të gjitha ushqimeve, është burimi më i pasur me "flavanoli", substanca biologjikisht aktive, të cilat gjenden tek ushqimet bimore. Të mos i ngatërrojmë me "flavanoli"-t e verës, të cilat mungojnë te kakaolja. Ato janë substanca intoksikuese, që gjenden në brendësi të saj, që mbrojnë nga sëmundjet kardiovaskulare dhe ndihmojnë në mbajtjen hapur të arterieve. Pak kakaolja mund t'i japë një shtysë kujtesës. Kakaolja, si çaji dhe kafeja, përmban substanca të ngacmuese të cilat veprojnë mbi receptorët e sistemit nervor, duke rregulluar efektshmërinë e qelizave. "Flavanoli" nxit një pjesë të mirë të përgjigjeve të neuroneve, që është reagimi i parë në bazë të fenomeneve shumë të vështira të kujtesës dhe kuptimeve. Kakaolja përmban Flavan-3-ols, një përbërës i cili ndihmon në uljen e presionit të gjakut. Përbërësit e kakaos njihen si nga antioksidantët më të përqendruar dhe që ju mbrojnë realisht nga sëmundjet e zemrës dhe nga kanceri. Po ashtu, mos harroni edhe çokollatën e zezë, e cila ju mbron nga rreziku i vdekjes.

Kakao kuron:

- 1-Të mbron nga sëmundjet kardiovaskulare
- 2-Është antidepresive
- 3-Bën të mundur uljen e presionit të gjakut
- 4-Parandalon kancerin
- 5-Zhvillon kujtesën

Llahanaja

Është një nga perimet më të veçanta që kohët e fundit, ka hyrë edhe në tregun tonë. Libra të tërë të Mjekësisë Popullore tregojnë se nëpërmjet kësaj bime, bëhet e mundur edhe pengimi i plakjes dhe rigjenerimi i lëkurës. Një arsye e mirë kjo për konsumimin të përditshëm, kryesisht për të gjithë ato femra që harxhojnë para pa fund në këmbim të rinisë së tyre.

Karota

Janë të njohura thajse për të gjithë njerëzit veçantitë dhe të mirat e karotës. Përveçse u bën shumë mirë dhëmbëve dhe ndihmon në zbardhjen e tyre, karota i jep energji trupit të njeriut dhe bën të mundur stabilizimin e nivelit të kolesterolit në gjak. Nuk lihen mënjatë dhe vetitë e betakarotenit, aq shumë i këshillueshëm edhe nga mjekësia moderne, si një element bazë për jetëgjatësinë dhe funksionimin e mirë të gjitha organeve të njeriut.

Hudhra

Hudhra është pa diskutim me vlera të jashtëzakonshme. Sipas mjekëve përdorimi i saj bën të mundur uljen e tensionit, ndalon mpiksjen e gjakut, bën mirë për zhdukjen e kancerit të stomakut dhe forcon qëndrueshmërinë e trupit. Për këto dhe shumë të tjera, rekomandohet përdorimi i hudhrës, nga të gjitha grupmoshat.

Vaji i ullirit

Vaji i ullirit është shumë i dobishëm për zemrën dhe ndikon në mirëfunksionimin e saj. Ky vaj ndikon në uljen e sasisë së kolesterolit në gjak, si dhe ul rrezikun e shfaqjes së kancerit te femrat. Të gjitha llojet e yndyrnave, si gjalpi, margarina dhe vajrat përmbajnë kalori të shumta, por që nga organizmi i njeriut perceptohen në mënyra të ndryshme. Greket e duan dhe janë përdoruesit e parë të vajit të ullirit dhe përdorin shumë pak gjalpin dhe margarinën. Vaji i ullirit është quajtur ndryshe nga mjekësia "Shoku më i mirë për gruan", pasi luan një ndikim shumë pozitiv në mbrojtjen nga kanceri i gjirit. Përmbajtja kryesore në vajin e ullirit është Vitamina E, e cila ka vetinë e rigjenerimit. Në përgjithësi vaji i ullirit, rron gjatë, si dhe duhet të mbahet në ambiente të freskëta dhe të thata, të mbrojtura nga drita.

Misri

Misri vazhdon të jetë numri një për të mbajtur konstante nivelin e kolesterolit në gjak, pasi unë ndjeshëm grafikun e yndyrës në gjak. Ai luan rol në prodhimin e energjisë trupore te njeriu. Në jug të Dakotës në ShBA, popullsia që prej vitit 1892 feston një festë me emrin "Festa e Misrit" ku njerëzit dekorojnë gjithçka me misër. Misri është një burim i vërtetë proteinash dhe vitaminash. Në një studim të bërë me meshkuj të cilët kishin kolesterol të lartë, pas një trajtimi me produkte misri, si dhe me ushqime të varfra në yndyre, u arrit në rezultate mjaft të kënaqshme. Misri gjithashtu është burim energjie. Ai përmban një lloj vitamine B (Thiaminë) që është e domosdoshme për njeriun. Në vendin tonë një përdorim të veçantë ka zënë "Buka e misrit" dhe gjithmonë është rekomanduar për njerëzit që vuajnë nga hipertensioni.

Mjalti

Mjalti ka aftësi kuruese për vetë vitaminën B që përmban. Mjalti përmban veti dezinfektuese për plagë dhe gërvishtje të lëkurës. Sipas studimit të Dr. Molan mjalti triumfon mbi 7 lloje të ndryshme bakteresh. Përveç shërimit të jashtëm mjalti ka dhe veti kuruese të brendshme, si në qetësimin e stomakut. Kështu për këta paciente do ishte e rekomandueshme 4 lugë çaji mjaltë në ditë. Një rol të rëndësishëm mjalti luan kundër diarresë, sidomos për fëmijët e vegjël, pasi është një metode, mjaft e mirë kuruese brenda një ushqimi. Mjalti në këtë rast, lufton bakteret dyfish më shpejt, se sa një tretje sheqeri. Gjithashtu, mjalti ndihmon edhe në rastin e problemeve me jashtëqitjen. Kujdes duhet treguar në përdorimin e mjaltit nga foshnjat. Në ndryshim nga fëmijët e vegjël dhe të rriturit, foshnjat nuk mund të përballojnë tretjen në mënyrë optimale të tij. Mjalti ka përmbajtje shumë të lartë sheqeri, 300 gram sheqer mund të krahasohen me 250 gram mjaltë.

5 të mirat e rrepave

Rrepat janë rrënjë me ngjyrë të kuqe. Ato kanë shije të ëmbël dhe janë shumë ushqyese dhe vitaminoze, pothuajse më tepër se çdo perime tjetër. Veçanërisht e shijshme është pjesa afër

me lëkurën mbuluese të rrepës. Efektet e rrepës janë të ngjashme me ato të spinaqit dhe të dyja këto bimë janë të nevojshme e të dobishme për organizmin. Rrepat përmbajnë folat dhe betainë, dy lëndë ushqyese të cilat ndihmojnë në ruajtjen e nivelit të gjakut, rindërtojnë arteriet e dëmtuara, zvogëlojnë rrezikun për sëmundjet e zemrës, etj. Mjekësia Popullore vë theksin tek domosdoshmëria e kësaj perimeje, madje këshillohet të gjithë amvisat që të përdorin sa më shumë të jetë e mundur në menynë e tyre rrepën e kuqe. Është e domosdoshme mësimi i fëmijëve që në vegjëli me shijen e rrepave.

- 1-Zvogëlojnë rrezikun e sëmundjeve të zemrës
- 2-Rindërtojnë arteriet
- 3-Ruajnë nivelin e gjakut
- 4-Ndihmojnë anemikët
- 5-Përmbajnë vitamina të ndryshme

Gujava

Gujava është një frut tropikal, pak i njohur në vendin tonë, por që ka filluar të zërë vend në tryezën e shumë vendeve evropiane. Ajo ka shije të ëmbël, por edhe pak të athët, për vetë sasinë e pakët të acideve trupore që përmban. Gujava përmban sasi të larta likopeni, një antioksidant i cili lufton kancerin e prostatës. Ky frut tropikal, si asnjë prodhim tjetër bimor përfshin në përbërjen e tij edhe përbërësit e domates dhe të limonit. Në fakt 1 gotë lëng nga fruti gujava përmban 688 mg potasium, një sasi që mund të gjendej te një banane. Të urtët kinezë, këshillojnë që të gjithë njerëzit, veçanërisht meshkujt të konsumojnë këtë frut, pasi thuhet që meshkujt nuk dinë t'i zgjedhin ushqimet e tyre dhe të hanë më shumë yndyrna, duke lënë mënjane ushqimet vitaminoze.

- 1-Përmban 688 potasium
- 2-Në përbërjen e tij ka domate dhe limon
- 3-Një gotë lëng nga ky frut, e barabartë me një banane
- 4-Përmban sasi të vogël acidesh
- 5-Shmang kancerit e prostatës

Lakra zvicerane

Bashkë me të gjitha llojet e tjera të bimëve jeshile të shitura në tregun e zarzavateve, në tregun evropian dallohet edhe një lloj tjetër bime jeshile, në formën e gjethes së lakrës. Kjo gjethe përmban lëndë të nevojshme për mirëfunksionimin e shëndetit. Në të gjenden përbërës të ndryshëm ushqimorë, ndër ta edhe betakaroteni. Në lakrën zvicerane gjenden kimikate të cilat mbrojnë retinën e syrit, si dhe përmban pigmente që akumulohen dhe shfaqen në retinën e syrit.

- 1-Ka formën e gjethes së lakrës
- 2-Përmban lëndë të nevojshme për organizmin

- 3-Në të gjenden përbërës të ndryshëm ushqimorë
- 4-Përmban betakaroteni
- 5-Përmban kimikate që mbrojnë retinën e syrit

Kanella

Kanella është një nga aromat dhe erëzat më të vjetra të njohura në botë, e cila njihet për ndihmën që jepet te burrat që kishin probleme me stomakun, vetëm nëse përzihet me sheqer. Kanella ndihmon në kontrollimin e nivelit të sheqerit në gjak, nivelet e larta të të cilit përbëjnë rrezik për shfaqjen e sëmundjeve të zemrës. Sipas studimeve, u zbulua se nëse të sëmurët me diabet tipi-2 konsumojnë kanellë për 6 javë, jo vetëm ulin nivelin e sheqerit në gjak, por edhe LDL, kolesterolin e keq.

- 1-Ndihmon meshkujt për problemet me stomakun
- 2-Ndihmon në kontrollimin e nivelit të sheqerit në gjak
- 3-Ndihmon në sëmundjet e zemrës
- 4-Të sëmurët me diabet duhet të konsumojnë kanellë për 6 javë
- 5-Ul nivelin e sheqerit në gjak dhe kolesterolin e keq

Purslana

Edhe pse për FDA, Agjencinë e Kontrollit të Ushqimeve në botë, kjo bimë përbën një bar të keq, një lloj droge, në shumë vende të tjera përfshirë Meksikën, Kinën dhe Greqinë, kjo bimë barishtore është shumë e njohur dhe e përdorur. Purslana përmban Omega-3, një përbërës i cili është shumë i dobishëm për sëmundjet e zemrës. Shkencëtarët shprehin se në të përmbahet 10 deri në 20 herë më shumë edhe melatonina, një antioksidant i cili parandalon prodhimin dhe shtimin e qelizave kancerogjene.

- 1-Bimë barishtore shumë e njohur dhe e përdorur
- 2-Purslana përmban Omega-3
- 3-E dobishme për sëmundjet e zemrës
- 4-Ajo përmban 10 deri në 20 herë më shumë melatonina
- 5-Parandalon prodhimin dhe shtimin e qelizave kancerogjene

Shega

Lëngu i shegës është pija më e preferuar për dekada të tëra, në vendet e Mesdheut Lindor dhe tani ka filluar të jetë edhe shumë e kërkuar në Amerikë. Disa shkencëtarë izraelitë kanë zbuluar se burrat që pinë një gotë me lëng shege në ditë, jo vetëm mbrohen nga kanceri i prostatës, por edhe rregullojnë sistemin e tyre sistolik, punën e zemrës dhe presionin e gjakut. Katër gota me një lëng të tillë do të plotësonin 50 për qind të nevojave tuaja ditore për Vitaminën C. Kështu ajo ndihmon jo vetëm në shumë procese trupore, por shton edhe rezervat e vitaminave në organizëm.

- 1-Mbron nga kanceri i prostatës
- 2-Rregullojnë sistemin sistolik
- 3-Rregullojnë punën e zemrës dhe presionin e gjakut
- 4-Përmban vitaminën C
- 5-Shton rezervat e vitaminave në organizëm

Farat e frutave

Farat e disa frutave në mjaft raste janë jo vetëm ngacmuese, por edhe të kujtojnë shijen e frutit nga janë marrë. Edhe pse frutat nuk mund t'i mbijetojnë kohës, me farat e tyre nuk ndodh e njëjta gjë e tillë, sidomos kur ato përpunohen dhe konservohen. Të tilla janë farat e kajsisë, bajamet, frutat e ndryshme të thata, etj. Këto fara dhe fruta të thata përmbajnë antioksidantë të cilat reduktojnë nivelin e insulinës rezistente në gjak e cila mund të jetë faktor rreziku për shfaqjen e diabetit.

- 1-Farat i mbijetojnë kohës
- 2-Ato mund të përpunohen dhe konservohen
- 3-Përmbajnë antioksidantë
- 4-Reduktojnë nivelin e insulinës rezistente
- 5-Parandalojnë shfaqjen e diabetit

Kumbulla e thatë

Pse janë të shëndetshme? Kumbullat e thara përmbajnë sasi të larta acidi neoklorogjenik dhe klorogjenik, antioksidantë që janë veçanërisht efektivë në luftën kundër “radikalit superoksid anion”. Ky radikal i keq shkakton dëmtime strukturale për qelizat dhe dëmtim i tillë mendohet të jetë shkaktari kryesor i kancerit. Si t'i hani? Si një meze. Mbështillni një copë të hollë proshute rreth kumbullës së tharë dhe ngulni një kunj dhëmbësh. Piqeni për disa minuta në furrë derisa kumbulla të jetë e butë dhe proshuta e tharë.

- 1-Përmbajnë sasi të larta acidi neoklorogjenik dhe klorogjenik
- 2-Janë efektivë kundër “radikalit superoksid anion”
- 3-Luftojnë kancerin
- 4-Rigjeneron qelizat e dëmtuara
- 5-I reziston kohës